

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7743 E mërkurë 19 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
Nëse shoh vetëm fotot, mund të mendosh, se deti i dritave të Budapestit është spektakël shtetëror për Krishtlindje. Por njerëzit që të dielën në ...
Vijon në faqen 20

Nga DAVID EHL
Paris, Budapest, Tiranë:
Po proteston gjysma e Europës?


Opinion Ditës
"Fantazia në pushtet" ishte një nga parullat e lëvizjes së '68-ës. I drejtohej një klase politike, e cila me kostumet dhe sjelljet e saj ngjante e vjetruar. Nëse ...
Vijon në faqen 21

Nga DRITAN HILA
Më mirë 100 studentë në shesh, se 10000 militantë!




BE: Kërkesat të marrin zgjidhje

Protesta para Kryeministrisë, Rama: Gati që të përgjysmoj tarifat

Studentët vazhdojnë të qëndrojnë në shesh. Meta: Të frenohet ikja e tyre

VALENTINA MADANI

Studentët protestuan sërish dje duke bllokuar disa kryqëzime dhe rrethrotullime kryesore në Tiranë. Grup tjetër studentesh janë vendosur para Kryeministrisë me thirrjet: "Ulni tarifat, plotësoni kërkesat"! ...

Në faqen 2

LISTA E PLOTE E 228 KANDIDATEVE QË DO TË TESTOHEN PROFESIONALISHT

EMRAT, MJEKET QË HYJNE NE PROVIMIN E SHTETIT

Qendra e Shërbimeve Arsimore: Dokumentacioni që duhet dorëzuar ditën e testit. Datat dhe orari për çdo mjek, rregullat e provimit që nis në datën 21 dhjetor



(Në foto) Mjekarë (foto ilustruese)

Në faqen 10

LEKSION ME STUDENTET



Politologu Afrim Krasniqi të "Luarasi": Jeni të mirëpritur për të kryer praktikë

Në faqen 11

Projektvendimi/ Këshilli Bashkiak i Tiranës: 550 familje, në listën e pritjes

Fituesit që do marrin shtëpi me kredi të butë

"4 muaj afat për të lidhur kontratë me bankën, ndryshe skualifikoheni"

Nga VOLTIZA DURO

Në datën 21 dhjetor të këtij viti do të mbahet mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, ku pritet miratimi i listës fituese të 500 familjeve që do të përfitojnë shtëpi me kredi të butë. "Gazeta Shqiptare"



Në faqen 8

zbardh sot projektvendimin për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë", për vitin 2018. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezultoi se nga 1082 aplikime, plot 1005 të tilla janë të rregullta dhe plotësojnë ...

KRYETARJA E LSI

Kryemadhi, letër Arta Markut: Të pezullohen punimet për Unazën e Re

Në faqen 4

VENDIMI

UKT, agjenti i ri i mbledhjes së taksës së pasurive të paluajtshme

Në faqen 9

SHOWBIZZ

Sukseset e VIP-ave shqiptarë nëpër botë, si ishte 2018 për artistët tanë

Suplement

SOT PERVJETORI

Luan Rama: Ali Demi, muajt e fundit në jetën e një heroi

Në faqen 18-19

PROTESTA E STUDENTEVE PREMTIMI

Protesta, studentët bllokojnë "21 Dhjetorin" dhe piramidën: Jo dialogut

Rama: Nga janari përgjysmohet tarifa për studimet bachelor

"Nëse ju kërkojnë më shumë, hajdeni tek unë"

Studentët protestuan sërish dje duke bllokuar disa kryqëzime dhe rrethrotullime kryesore në Tiranë. Grup tjetër studentesh janë vendosur para kryeministrisë me thirrjet: Ulni tarifat, plotësoni kërkesat! Nuk ka dialog. Edhe pse më të paktë në numër, studentët qëndruar përpara godinës së kryeministrisë duke ripërsëritur thirrjen se nuk do të këtë dialog pa plotësimin e kushteve, që tashmë ndodhen në tavolinën e kryeministrit Edi Rama.

KRYEMINISTRI

Kryeministri Edi Rama u premtoi dje studentëve se nga janari do të nisë përgjysmimi i tarifës për nivelin Bachelor. Gjatë një diskutimi dje me studentët dhe pedagogë të Universitetit Buqësor të Tiranës, z.Rama njoftoi se kjo është një nga pikat që studentët kërkojnë, duke i kërkuar atyre që nëse në janar universiteti i kërkon pagesë, ata duhet ta refuzojnë. "Në janar nuk do t'i paguani, ja po ta them sot. Në janar ju do të paguani 50% më pak të tarifës. Ja ta thashë një. Nëse do vini në janar dhe do ju kërkojnë ju do të refuzoni të paguani në janar tarifën. Do ta refuzoni. Nëse ju thonë do ta paguash, do t'i thuash jo nuk e bëj", - deklaroi z.Rama. Por studentët i kërkuar deklarata zyrtare lidhur me premtimin e bërë. Për këtë kryeministri u përgjigj: "Deklarata zyrtare ty nuk të bëj, as ty dhe askujt. Ne jemi këtu partnerë, nuk me ke marrë peng që të të bëj deklaratë zyrtare. Unë jam këtu me zë dhe figurë 198 cm dhe po t'i them gjërat dhe po i dal për zot këtyre gjërave. Deklaratë zyrtare që të të jap unë ty dhe të shkosh të festosh Vitin e Ri dhe të të them shko festo se me ke marrë peng kjo nuk ndodh. Atyre që jua thonë këtë u thonë që kjo nuk është demokracia. Fjala është këtu dhe janari vjen tani. Nëse ju do ju thotë Universiteti e ka bërë qeveria, atëherë hajdeni prap atje. Se kur do t'ia paguajmë ne universitetit është punë për ne. Ju nuk do ta paguani".

DEBATI

Bashkëbisedimi i kreu të qeverisë me studentët e Universitetit Buqësor u shoqërua me replika dhe debate, të cilat kulmuan me revoltën e studentes Armela Mikli që braktisi takimin në shenjë revolte pasi nuk ishte informuar për praninë e kryeministrit. Tarifat e larta dhe kushtet në godinat universitare ishin ato që përplasën në



Kryeministri Edi Rama

REKTORI

Takimi në Universitetin Buqësor të Tiranës është shoqëruar me tone të ashpra, por edhe përplasje mes studentëve, kryeministrit Edi Rama dhe rektorit. Një shprehje e rektorit Bahri Musabelliu 'S'kam këllqe', është bërë objekt debati mes tij dhe një studenti, ku ky i fundit e ka ironizuar.



Protesta e djeshme e studentëve

RIMBURSIMI

Z.Rama tha se qeveria po planifikon që studentët me 9 dhe 10 dhe ata që vijnë nga familjet e varfra të rimbursohen 100%. "Po punojmë, ata me 10, ata me 9 me, 8 ata me ndihmë ekonomike dhe pasi ta artikulojmë të gjithën këtë do i themi universitetit urdhëro lekët për ata që përfitojnë", - tha kryeministri.

OSBE: Dialog mes studentëve dhe qeverisë

Protesta, BE: Koha për dialog, kërkesat të marrin zgjidhje

Delegacioni i BE në Shqipëri përshëndeti dje protestën dy javore të studentëve, ndërsa kanë bërë thirrje që tashmë të këtë një dialog për të gjetur zgjidhjen e të gjitha këtyre kërkesave. Në një reagim në 'Facebook', delegacioni i BE-së shprehet se protestat paqësore të studentëve në Shqipëri janë një shprehje e shëndetshme e demokracisë. Delegacioni i BE-së thotë se ekziston një konsensus i gjerë publik në shoqërinë shqiptare lidhur me kërkesat e tyre. "Protestat paqësore të studentëve në Shqipëri janë një shprehje e shëndetshme e demokracisë. Ekziston një konsensus i gjerë publik në shoqërinë shqiptare lidhur me kërkesat e tyre. Stu-



dentët bëjnë thirrje për standarde më të mira arsimore. E drejta për arsim është qendrore në çdo shoqëri. Ashtu siç është lufta kundër korrupsionit. Tani është koha për të ndërtuar një dialog që siguron që këto kërkesa të përkeqësohen në zgjidhje konkrete dhe praktike", thuhet

në reagimin e delegacioni të BE. Edhe OSBE kërkoi dje zgjidhje për studentët. Nga Shkodra ku ai mori pjesë në një takim për krimin mjedisor, apeloj që të këtë dialog mes palëve, duke iu bashkuar kështu mesazheve të ndërkombe të, që mes qeverisë dhe studentëve duhen diskutuar 8 kërkesat e parashtruara. "Kërkesat e studentëve fokusohen në ndryshimin e sistemit arsimor dhe kjo nuk është në fokus të misionit të OSBE-së. Në të njëjtën kohë ne mbështesim të drejtën për të pasur një protestë paqësore. Dhe ashtu si i gjithë komuniteti ndërkombe, edhe ne kemi kërkuar që të këtë dialog", -tha z. Borchardt.

Meta: Përkushtimi në arsimimin e rinisë, frenon largimin e tyre

Në Ditën Ndërkombëtare të Emigrantëve, Kreu i Shtetit, Ilir Meta shprehet se vëmendja maksimale në arsim, është mënyra më e mirë për të frenuar largimin e të rinjve nga Shqipëria. Meta, teksa risjell porosinë e veçantë të Papa Franceskut thekson se të gjithë së bashku duhet të bëjnë ç'mos që Shqipëria të mos pësojë 'dimrin demografik'. "Sot në Ditën Ndërkombëtare të Emigrantëve, dua të risjell edhe njëherë në vëmendje porosinë e veçantë të Papa Franceskut, që të gjithë së bashku duhet të bëjmë çmos që Shqipëria të mos pësojë "dimrin demografik" të Europës. Me përkujdesje, përkushtim dhe vëmendje maksimale në edukimin, arsimimin dhe krijimin e mundësive më të mira për të rinjtë, të frenojmë largimin e tyre dhe t'ju mundësojmë ndërtimin e një të ardhmeje të sigurtë e të qëndrueshme në Shqipëri", - shprehet z.Meta.



MBËSHETJA

Avokati i Popullit deklaroi se përgjigjet dy viteve i është drejtuar me rekomandime Ministrisë së Arsimit dhe universiteteve, por përgjigjet kanë qenë sipërfaqësore dhe në disa raste janë injoruar. Avokati i Popullit apelon për krahe për shtresat në nevojë.

qëndrime kryeministrin dhe studentët, me këta të fundit që ironikisht ia thanë në sy ish-in katrajzojë. Sa i përket bllokimit të doktoraturave Rama nënvizoi se është e pampranueshme që një profesor të udhëheqë disa studentë njëkohësisht për të qenë doktorant. "Më thoni mua si mund të bëhesh doktor sh-

kencash, si mund të jetë një klasë e tërë me doktor shkencash me një profesor. Në cilin vend ndodh kjo. Pastaj vijmë tek shqetësimi normal, që jemi vendi me numrin më të madh të doktorëve të shkencave për kilometër katror", theksoi Kryeministri. Z.Rama foli edhe për sëmtë të tjera, teksa tha se sh-

shumë se 1 mijë punonjës të universiteteve janë të punësuar jashtë parashikimeve ligjore. Kryeministri premtoi sërish rikonfigurim të bordeve të universiteteve, edhe pse nuk pranon se përfaqësuesit e qeverisë janë bërë pengesë për autonominë. Këtu e gjen me vend të risulmojë disa rektorë për shpër-

dorime të fondeve. Pyetjes për mosmbajtjen e premtimit elektoral për buxhet 5% për arsimin, Rama i përgjigjet me një analizë të situatës ekonomike që gjetën. Kërkesës për vettingun e pedagogëve, i përgjigjet me kërkesën për të denoncuar çdo rast. Rama vazhdon të vlerësojë frymën e protestës, që thotë se shër-

beu si stimul për të ndërmarrë diskutime që universitetet të reformohen. Rama premtonte përmbushjen e të gjitha kërkesave, edhe shumë të tjerave që u artikulojnë në diskutimin me studentët e Universitetit Buqësor dhe thotë se do të vazhdojë të flasë dhe takohet me ta në çdo auditor për të folur.



Mazhoranca e majtë ka hedhur poshtë propozimin e Metës për Vitore Tushën

PS rrezon dy dekretet e presidentit për buxhetin dhe KLSH-në

Miratohet kandidatura e Ridvan Bodes për BSH

Shumica qeverisëse ka rrezuar dje në Komisionin e Ekonomisë dy dekretet e Presidentit Ilir Meta që kanë të bëjnë me rikthimin për diskutim të buxhetit të shtetit 2019 dhe propozimin e Vitore Tushës si kryetare e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Fillimisht komisioni shqyrtoi dekretin për rikthimin e buxhetit, për të cilin ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj u shpreh se ligji në fjalë është kthyer pa dhënë asnjë shpjegim sa i përket përmbajtjes së tij dhe raportit të tij me Kushtetutën. "Dekreti është kthyer pa referuar asnjë detaj, në aspektin e financimit të arsimit apo kërkesë specifike. Praktikisht e ka kthyer buxhetin në parim. Çdo refuzim ndaj dialogut është i' bësh një tradhti kauzës së studentëve", tha ai. Edhe përfaqësuesit e tjerë të mazhorancës në këtë komision janë shprehur kundër përdorimit të buxhetit në debatin që ka shkaktuar protesta e studentëve. Ndaj në fund të këtij diskutimi ata kanë votuar për rrezimin e dekretit.



Deputetët e PD dhe LSI do marrin pjesë në seancë

Studentët dhe vetingu "shpëtojnë" mandatet e opozitës

Nesër opozita do të kthehet në parlament duke i dhënë fund bojkotit. Vendimi është marrë gjatë takimit të kryetarit të PD, Lulzim Basha me aleatët ku u ra dakord që deputetët të jenë në seanca të enjten sepse diskutohet dekreti i Presidentit Meta për buxhetin, por edhe të premtën, sepse diskutohet vetingu në politikë. Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi sqaroi për mediat se janë studentët ata që po kthejnë opozitën në parlament, pasi për kauzën e tyre deputetët do të shkojnë në seancë. "Ne të rikthyer në parlament jemi, nuk kemi ikur ndonjëherë. Do të jemi në seancë për ata studentë që Rama tallet dhe i manipulon. Nuk i ka bërë Rama ditët dhe nuk është aq i zoti, se nuk është as doktor shkencash as piktor, por një kryeministër i lidhur me krimin, që vjedh paratë e studentëve për xhepat e tij", tha Kryemadhi. Kthimi i opozitës në Kuvend shpëton edhe deputetët nga dëgjia e mandateve pasi një pjesë e tyre po arrinin limitin e mungesës në parlament. Ndërkohë që kreu i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Edmond Spaho, u shpreh për mediat se opozita nuk kthehet në Kuvend për një marrëdhënie normale, por për studentët. "Ne s'jemi kthyer në Kuvend për marrëdhënie normale, por mbështesim kërkesat e studentëve. Zërin e tyre do të paraqesim atje", u shpreh ai. Ai shtoi se me Ramën kryeministër vendi nuk ka normalitet. Për sa i përket draftit të vetingut në politikë, Spaho u shpreh se "Nuk ishte i nevojshëm dërgimi në Venecia". Të gjithë deputetët e opozitës rrezikonin të digjinin mandatet nëse brenda dhjetorit nuk do arrinin të merrnin pjesë qëoftë edhe në një seancë të vetme. Kjo pasi ata mbushnin 6 muaj plotë që nuk merrnin pjesë në jetën parlamentare dhe për rrjedhojë në bazë të Kushtetutës, mandati i tyre mund të digjej.



KRYEMADHI
"Ne të rikthyer në parlament jemi, nuk kemi ikur ndonjëherë. Do të jemi në seancë për ata studentë që Rama tallet dhe i manipulon. Nuk i ka bërë Rama ditët dhe nuk është aq i zoti, se nuk është as doktor shkencash as piktor, por një kryeministër i lidhur me krimin, që vjedh paratë e studentëve për xhepat e tij", - tha Kryemadhi.

VITORE TUSHA

Më tej, komisioni shqyrtoi edhe dekretin e dytë të ardhur nga Presidenti i Republikës me anë të të cilit ai propozoi Vitore Tushën si kryetare e re e KLSH-së. Deputetët socialistë vlerësuan kandidaturën e saj si një juriste, por vlerësuan se zgjedhja e saj në krye të KLSH-së do demtonte institucionet e tjera të drejtësisë, siç është Gjykata Kushtetuese dhe KED, ku ajo është anëtare. Ndërkohë që sipas Erion Braçes, kryetar i komisionit, Tusha nuk ka eksperiencën e duhur për auditimet financiare. "Znj. Tusha është e angazhuar në organet e reja të drejtësisë dhe duhet të ushtrojë të gjitha kompetencat lidhur me verifikimin e përbushjes së kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale të kandidatëve".



BRACE

"Znj. Tusha është e angazhuar në organet e reja të drejtësisë dhe duhet të ushtrojë të gjitha kompetencat lidhur me verifikimin e përbushjes së kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale të kandidatëve".



BUXHETI

"Dekreti është kthyer pa referuar asnjë detaj, në aspektin e financimit të arsimit apo kërkesë specifike. Praktikisht e ka kthyer buxhetin në parim", - tha Ahmetaj.



DEKLARATAT

BODE

"Unë e marr ftesën i zhveshur nga të gjitha ngarkesat politike dhe do kontribuoj, që ajo politikë të jetë më e mira dhe më e drejta për reformat e vendit".

Ahmetaj: 6300 studentë nga familjet në nevojë nuk do kenë tarifa

Ministri i Financave u shpreh se buxheti i vitit 2019 i ka të gjitha mundësitë që të furnizojë kërkesat e studentëve. Madje ai bëri të ditur edhe disa hapa konkret që ministria që ai drejton në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit ka bërë për të plotësuar një nga kërkesat kryesore të studentëve dhe që ka të bëjë me tarifat. "Qeveria ka një ofertë për subvencionim e tarifave të studentëve deri në përjashtimin e tyre. Studentët e ekselencës me mesatare nga 9 deri në 10 do t'ju subvencionohet tarifa në masën 100% nga shteti. Gjithashtu, edhe 6300 studentë të familjeve në nevojë përjashtohen nga pagesa e tarifës, duke u trajtuar sikurse studentët e ekselencës si dhe do t'ju jepet një bursë prej 10 mijë lekësh në muaj", tha ministri, ndërsa theksoi se fondi që shkon për mbështetjen tarifore, do të merret nga granti që qeveria adreson për universitetet, me vlerë 7.4 miliardë lekë.



plenary. KËSHILLI I BSH

Më pas komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga Këshilli i Ministrave me për tre anëtarë për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, Ridvan Bode, Suela Popa dhe Edlira Luçi. Të tre kandidatët bënë një prezantim të jetës së tyre akademike dhe u shprehën se do japin kontributin e tyre në përbushje të detyrimeve ligjore të Bankës së Shqipërisë. "Unë mendoj se me eksperiencën dhe formimin si ekonomist dhe filozofik do të kontribuoj në një debat konstruktiv, të shëndetshëm dhe të dobishëm. Unë e marr ftesën i zhveshur nga

të gjithë ngarkesat politike, dhe do kontribuoj, që ajo politikë të jetë më e mira dhe më e drejta për reformat e vendit. Unë kam formimin tim ideologjik dhe orientimin tim filozofik dhe do të jem besnik" deklaroi ish-ministri demokrat, Ridvan Bode. Në vijim, komisioni dëgjoi dhe dy kandidatët tjerë për anëtarë Këshillit të Bankës së Shqipërisë, Artan Hoxhën dhe Luljeta Minxhoni, kandidatura këto të propozuara nga 28 deputetë të Kuvendit të Republikës. Në seancë nuk ishte dje i pranishëm ish-ministri tjetër socialist, Arben Malaj, i cili siç bëri të ditur vet Kuvendi mungonte për arsye personale.

PROTESTA AKUZAT

Skandali me Unazën e Madhe, PD paralajmëron publikimin e fakteve të reja mbi aferën

Basha: Njeriu i lidhur me krimin, që do ndërtojë pallate tek Unaza

Banorët e "Astirit" dënojnë kërcënimet ndaj Rakipit

Valentina Madani

Banorët e "Astirit" protestuan sërish dje me jelekë portokalli kundër shembjes së banesave të tyre. Me thirrjet "Toka jonë, "Shtëpia jonë", "Poshtë projekti", "Qeveri hajdute", banorët e Unazës së Re kundërshtuan projektin sipas tyre abuziv në kurriz të pronave të tyre. Ata iu bënë thirrje banorëve të tjerë për t'u bashkuar. "Kjo lëvizje u nis për të mbrojtur shtëpitë tona, por ky zaptuesi i karriges së kryeministrit tha që ne jemi zaptues dhe e kishte me shumë nxitim për të shkatërruar shtëpitë tona. A e shikoni se çfarë fshihej pas këtij nxitimi? Karrigia e kryeministrit po tundet dhe jo vetëm nga ne. Këta njerëz të babëzitur të pushtetit nuk po shohin as për arsimin e as për shëndetësinë, po donin të nxirrnin banorët në mes të dimrit jashtë", deklaruan banorët. Ata shprehën solidarizimin e tyre për kërcënimet me jetë ndaj drejtuesit të emisionit "Të Paekspozuarit", i cili zbuloi skandalin me kompaninë fituese të lotit të parë prej 18 milionë eurosh për rindërtimin e Unazës së Madhe. "Solidarizohemi me Ylli Rakipin dhe Unaza e Re i ka dhënë besën Ylli Rakipit. Çdo kërcënim ndaj gazetarëve është kërcënim ndaj banorëve të Unazës dhe ne do t'i mbrojmë me të drejtën që na jep Kushtetuta dhe ligji. I bëjmë thirrje Prokurorisë të lëvizë, sepse dita-ditës gjendja po përkeqësohet. Ne e kemi bërë të ditur se këtu ka krim", - shprehen banorët.

DENONCIMI

Kreu i PD-së, Lulzim Basha paralajmëroi dje publikimin e të tjerave fakteve lidhur me aferën korruptive të qeverisë tek Unaza e Re. Teksa ishte në krah të banorëve të "Astirit" në ditën e 45 të protestës së tyre, Basha tha se Rama jo vetëm ka dashur të vjedhë 40 milionë euro nga buxheti i shtetit, por së bashku me krimin e organizuar kërkon të ndërtojë pallate shumëkateshe. "Nesër (sot) PD do të




Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje me banorët e Unazës së Re

AFERA

Kreu i PD, Lulzim Basha mori dje pjesë në protestën e banorëve të zonës së "Astirit", të cilët preken nga projekti i Unazës së Re. Në ditën e 46 të protestës, Basha paralajmëroi se sot PD do publikojë fakte dhe dokumente të reja të asaj, që ai e quan aferë korruptive.

Skandali me Unazën, Kryemadhi letër Arta Markut: Pezullo punimet

Pas skandalit me ten derin e Unazës së Madhe, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi i është drejtuar sot me një letër Prokurorisë së Përgjithshme, Arta Marku. Në letër që mban firmën e saj, numri një i LSI-së kërkon nga kryeprokurorja pezullimin e punimeve në të gjithë projektin e Unazës së Re deri në sqarimin përfundimtar të rrethanave të kësaj çështjeje. Më herët në një takim me Lëvizjen e Gruas Socialiste për Integrim, kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi apeloj prokuroren e përgjithshme, Arta Marku të hetojë me gaskandalin e Unazës së Madhe. "I bëj thirrje Arta Markut si grua dhe si nënë, që sot ajo është përballë opinionit publik, përballë opozitës e ndërkombehtarëve të tregojë se



FALËNDERIMI

Kërkesa e Monika Kryemadhit adresuar Prokurorisë së Përgjithshme u përshëndet nga banorët e Unazës së Re, gjatë protestës së zhvilluar pasditën e djeshme. Kryetarja e LSI kërkoj dhe zyrtarisht nga Prokuroria e Përgjithshme që të pezullojë punimet në Unazën e Re të Tiranës.

vlerat e një gruaje janë më të forta se të institucioneve dhe tundimi e paraja. Ajo sot duhet të jetë e sinqertë me veten e saj, me fëmijët e saj, me gratë shqiptare. He-toje si burrneshë, nëse je

burrneshë, se sot ke shansin për t'u dhënë emër grave dhe vajzave shqiptare". - deklaronte Kryemadhi në takimin me Lëvizjen e Gruas për Integrim, më 8 dhjetor.

publikojë një pjesë tjetër po kaq të errët të kësaj afere korruptive. Jo vetëm që Edi Rama ka dashur të vjedhë dhe vazhdon të përpigjet të vjedhë këtu mbi 40 milionë euro nga Buxheti i Shtetit, por së bashku me figurat e kriminit të organizuar, mbi rrënojat e shtëpive që do të prishë do të ndërtojë pallate shumëkateshe. Nesër para qytetarëve

do të shpalojet me dokumente zyrtare se si Edi Rama dhe Erion Veliaj ndryshuan planin urbanistik për t'i dhënë leje një kriminelit të dënuar me 21 vjet burg për trafik droge, një personi i cili njihet si mik, si bashkëpunëtor i kupolës socialiste, Edmond Bego. Për t'iu freskuar kujtesën qytetarëve, Edmond Bego është njeriu, i cili në

kundërshtim me ligjin, ndonëse i dënuar nga drejtësia italiane dhe vuajti një pjesë të dënimit këtu në Shqipëri, mori mbi 14 milionë euro tendera në Rrugën e Elbasanit, në zonën elektorale të Taulant Ballës, me të cilin ka udhëtar plot 57 herë jashtë shtetit në katër vitet e fundit", deklaroi z.Basha. Sipas tij, "nuk është rastësi por



Protesta e djeshme e banorëve të "Astirit"

DENONCIMI

Sipas Bashës, Rama jo vetëm që ka dashur të vjedhë 40 mln euro buxheti i shtetit, por do të ndërtojë pallate me paratë e drogës. Basha tregoi edhe emrin e biznesmenit, i cili sipas tij do të ndërtojë pallate tek Unaza e Re.



Basha mbledh Këshillin Kombëtar: Mbështetje çdo proteste

Partia Demokratike zhvilloi dje mbledhjen e parë me anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar për të diskutuar mbi situatën politike në vend. Gjatë mbledhjes së djeshme nuk është marrë asnjë vendim, por do të ndërron vendosjen e anëtarëve të rinj. Mësohet se kreu i PD-së ka kërkuar nga anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar që të mbështesin të gjitha protestat që zhvillohen në vend, siç është ajo e studentëve, protesta e banorëve të zonës së "Astirit" apo dhe protesta të tjera. Basha ka kërkuar mobilizim për protestën e studentëve si dhe për protestën e fermerëve dhe biznesit të vogël e parashikuar për të enjten para Kuvendit. Kreu i PD-së, Lulzim Basha, ka kërkuar që anëtarët e rinj të Këshillit Kombëtar të bindin njerëzit që të mbështesin protestat e zhvilluara.

është provë e përfshirjes së drejtpërdrejtë e Edi Ramës dhe kupolës së tij, është pjesë e përgjegjësisë kriminale të Edi Ramës dhe Erion Veliajt, që shtëpitë e këtyre shqiptarëve këtu, e këtyre banorëve, e këtyre vogëlushëve, do prisheshin që të ndërtonte pallate shumëkateshe, një person i dënuar për trafik ndërkombëtar droge dhe për

të pastruar paratë e drogës dhe për të ndarë kaparin me Edi Ramën, me Erion Veliajn, me Taulant Ballën dhe me kupolën socialiste". Për Bashën, mosveprimi i prokurorisë tregon jo vetëm e thjesht kapjen e prokurorisë nga Edi Rama, por po tregon po kështu se Arta Marku dhe kupola e saj janë bashkë-fajtores.



Zbuloi megaskandalin, falsifikimi nga kompania që fitoi tenderin e Unazës së Re

Kërcënohet me jetë drejtuesi i "Të Paeksponuarit", Ylli Rakipi

Kërcënime direkte dhe përmes postës elektronike

Drejtuesi i emisionit "Të Paeksponuarit", Ylli Rakipi, ka marrë mesazhe kërcënuese për jetën. Këto kërcënime vijnë menjëherë pas publikimit të aferës korruptive me tenderin e Unazës së Re dhe personave të cilët qëndrojnë pak kësaj afere. Kërcënimet në drejtim të gazetarit janë të formave të ndryshme. Ato janë bërë së pari në mënyrë indirekte, nëpërmjet postës elektronike dhe më pas edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Lidhur me këto kërcënime, gazetari u është drejtuar organeve kompetente. Pavarësisht kërcënimeve dhe shantazheve, emisioni "Të Paeksponuarit" do të vijojë të kryejë detyrën dhe misionin e vet në interes të publikut.



Drejtuesi i emisionit "Të Paeksponuarit", Ylli Rakipi

KERCENIMI
Kërcënime në drejtim të gazetarit Ylli Rakipi janë të formave të ndryshme. Ato janë bërë së pari në mënyrë indirekte, nëpërmjet postës elektronike dhe më pas edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Lidhur me këto kërcënime, gazetari u është drejtuar organeve kompetente. Pavarësisht kërcënimeve dhe shantazheve, emisioni "Të Paeksponuarit" do të vijojë të kryejë detyrën dhe misionin e vet në interes të publikut.

SHKURTE

Kërcënimet ndaj Rakipit, PD: Autori e frymëzuesi, Rama

Partia Demokratike dënon kërcënimet ndaj gazetarit Rakipi, duke theksuar se ai denoncoi vjedhjen dhe pastrimin e 30 mln eurove nga Edi Rama. PD shpreh mbështetje për kurajën e treguar nga ai për denoncimin e megaskandalit në lidhje me tenderin për Unazën e Madhe. Sipas PD-së, autori i vërtetë në këtë rast është Edi Rama. "Partia Demokratike dënon në mënyrë më të ashpër kërcënimet që i janë bërë gazetarit Ylli Rakipi. Ne jemi në krah të zotit Rakipi, me të njëjtën kurajë dhe vendosmëri me të cilën ai ka denoncuar vjedhjen dhe pastrimin e 30 milionë eurove nga Edi Rama, përmes një skeme ndërkombëtare kriminale. Kërcënimi ndaj Ylli Rakipit nuk është thjesht kërcënim ndaj një gazetari, por është kërcënim ndaj gjithë shoqërisë sonë. Kur krimi guxon të kërcënojë një njeri të medias, në kohën kur autorët e skandalit janë të gjithë të identifikuar, kjo do të thotë vetëm një gjë: krimi ndjehet më i fortë se shteti dhe se drejtësia. Pavarësisht se kush është personi që ka bërë direkt kërcënimin, autori i vërtetë është Edi Rama, frymëzuesi, ortaku dhe mbrojtësi kryesor i krimit në vend. Asnjë gytetar nuk është më i mbrojtur në Shqipëri dhe nuk do të jetë derisa Edi Rama të largohet nga pushteti", thuhet në deklaratën e PD-së.

Kërcënim i ndaj Rakipit, AMA: Të zbardhen rrethanat

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) reagoi dhe pas kërcënimeve që i janë drejtuar gazetarit Ylli Rakipi. AMA ka shtuar se kërcënime të tilla ndaj gazetareve janë të përsëritura, gjithashtu se dënon çdo përpjekje që cenon dhe rrezikon fjalën e lirë dhe integritetin e angazhimit të komunitetit të medias. "Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, po përcjell me shumë shqetësim lajmet për kërcënime serioze që ka marrë drejtuesi i programit të njohur televiziv "Të paeksponuarit", z. Ylli Rakipi. Si një rast i përsëritur i presionit në forma të ndryshme ndaj gazetareve në detyrë, AMA dënon çdo përpjekje që cenon dhe rrezikon fjalën e lirë dhe integritetin e angazhimit të komunitetit të medias. AMA solidarizohet me z.Rakipi dhe apelon për autoritetet, që menjëherë të zbardhin rrethanat dhe të venë para përgjegjësisë ligjore fajtorët e këtij akti të rëndë, si dhe të garantojnë një klimë të sigurt dhe normale për redaksitë dhe gazetarët në ushtrimin e detyrës dhe misionit të tyre për të informuar publikun", thuhet në reagimin e AMA-s.

SKANDALI

Emisioni "Të Paeksponuarit" i Ylli Rakipit publikoi dokumentet që faktonin se "Dunwell Haberman" kishte falsifikuar dokumentet, bilanci dhe firmën e Sekretarit të Shtetit në Delaware për të fituar tenderin e Unazës së Tiranës me vlerë 18 milionë euro. Kjo kompani ishte krijuar vetëm në 25 qershor të këtij viti, por pas plasjes së skandalit qeveria u detyrua të anulonte tenderin e lotit të parë të Unazës së Re.

Presidenti, apel institucioneve ligjzbatuese

Pas kërcënimeve, Meta takon gazetarin Rakipi: Hetim me përgjegjësi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta takoi dje gazetarin Ylli Rakipi, i cili është kërcënuar për jetën me mesazhe elektronike dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. Para pak javësh emisioni "Të Paeksponuarit" ka arritur të zbulojë një megaskandal, lidhur me kompaninë "Dunwell Haberman" (kompania mëmë e "DH Albania"), e cila është fituese e lotit të parë prej 18 milionë euro për rindërtimin e Unazës së Madhe. Kjo kompani ka depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri një letër nga Sekretari i Shtetit të Delaware, Jeffrey Bullock, për të vërtetuar se kompania është themeluar në vitin 1998. Por, "Të Paeksponuarit" ka zbuluar se ky dokument është i falsifikuar. Stafit i emisionit kontaktoi me Departamentin e Shtetit të Delaware, për të vërtetuar autenticitetin e dokumentit që ka depozituar në Shqipëri, kompania "off-shore". Përgjigja që morëm prej tyre ishte shokuese. Njëkohësisht emisioni "Të Paeksponuarit", i dërgoi Departamentit të Shtetit të Delaware, aktin e themelimit të kompanisë, dorëzuar në QKB-në shqiptare, ku sërisht pretendohet se data e themelimit të kompanisë është 25 qershor 1998. Përgjigja e zyrtarëve të Departamentit të



nimet ndaj tij për shkak të detyrës. Presidenti Meta shprehu solidaritetin e tij me z.Rakipi dhe të gjithë gaze-

tarët që me guxim e profesionalizëm i shërbejnë interesit publik përmes fakteve dhe të vërtetave. Presidenti Meta apelon ndaj institucioneve ligjzbatuese të hetojnë me përgjegjësi maksimale këtë rast, me qëllim ndëshkimin e merituar të autorëve", thuhet në njoftimin e Presidencës. Njëkohësisht, Presidenti Meta u bën thirrje të gjithë gazetareve të denoncojnë çdo presion e shantazh që u bëhet në cenim të misionit të tyre, i cili është vendimtar për demokracinë e sundimin e ligjit.

Shtetit të Delaware qe e njëjtë. Edhe ky dokument ishte falsifikuar. Pas emisionit "Të paeksponuarit", transportuar të enjten në mbremje në "News 24", "Prokuroria e Tiranë nisi hetimet në lidhje me faktet e bëra publike. Mësohet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë po kryen ve-

rimet hetimore në lidhje me faktet e bëra publike mbi rregullshmërinë e veprimeve të kryera, për ndërtimet e planifikuara në Unazën e Re. Verifikimi bëhet për veprat penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga

neni 186 i Kodit Penal, "Shkelje e barazisë në tendera", parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal. Prokuroria shqiptare garanton vlerësimin me objektivitet të fakteve, objekt i këtij hetimi duke kryer veprimet hetimore brenda një afati të arsyeshëm", thuhet zyrtarisht nga Prokuroria.

Nuk do lejohen më shumë se 3 % të ardhur nga ushtria

PS kundër Lleshajt, jo ushtarakë në pozicionet drejtuese të policisë

Deputetët socialistë të Komisionit të Sigurisë kanë hedhur poshtë propozimin e ardhur nga ministri i ri i Brendshëm që ushtarakët të mund të bëhen pjesë radhëve të forcave të policisë në rangje drejtuese. Pas një diskutimi të gjatë komisioni ka vendosur me shumicë votash që amendamenti i paraqitur nga Ministria e Brendshme të kufizohet duke përcaktuar se vetëm 3 për qind e forcave të policisë mund të vijnë nga forcat ushtarake, por duke përjashtuar postet drejtuese.

KOMISIONI

Pas një diskutimi të gjatë komisioni ka vendosur me shumicë votash që amendamenti i paraqitur nga Ministria e Brendshme të kufizohet duke përcaktuar se vetëm 3 për qind e forcave të policisë mund të vijnë nga forcat ushtarake, por duke përjashtuar postet drejtuese.

ka theksuar se të gjitha eksperimentet e bëra më parë me Policinë e Shtetit kanë sjellë dëmtrim të kësaj të fundit.

"Politika ka eksperimentuar keq me policinë e shtetit. Eksperimentet kanë shkuar deri tek kalduajt", tha

Ndreu. Por ministri Lleshaj sqaroi se bëhet fjalë vetëm për plotësimin e sektorëve në policinë e shtetit ku ka mungesë specialistësh dhe jo për të bërë ushtarakët drejtues të saj. "Pranimi bëhet me vullnetin e lirë të ushtarakëve pas nxjerrjes së tyre në lirim nga Forcat e Armatosura, mbi bazë konkurrimi. Krahas njohjes së vjetërsisë



Ministri i Brendshëm Sander Lleshaj

së shërbimit do t'u njihet edhe grada, e cila do t'i ekuivalenohet me një gradë korresponduese policore. Nuk bëhet fjalë për të marrë ushtarakë dhe për t'i bërë drejtor apo zëvendës drejtor, por për të marrë specialistë në ato fusha ku kemi nevojë", sqaroi Lleshaj.

Socialistët përfundojnë reformën, dorëzojnë në Kuvend ndryshimet në Kod

PS: Përdorim të teknologjisë në zgjedhje dhe votim të emigrantëve

Në ndryshime parashikohet edhe depolitizim i komisioneve

Në mungesë të opozitës, Partia Socialiste ka paraqitur në Kuvend paketën e plotë të amendamenteve në Kodin Zgjedhor të bëra në kuadër të reformës zgjedhore. Pavarësisht mospërfshirjes së PD-së në hartimin e këtyre amendamenteve, socialistët duket se kanë marrë parasysh disa nga propozimet e saja që kanë të bëjnë kryesisht me përdorimin e teknologjisë në zgjedhje, depolitizimi i administratës zgjedhore apo edhe çështjet që kanë të bëjnë me financimin dhe përdorimin e administratës në zgjedhje.

TEKNOLOGJIA

Në draftin e paraqitur nga socialistët i kushtohet një rëndësi e veçantë përdorimit të teknologjisë në zgjedhje dhe në mënyrë konkrete në procesin e identifikimit elektronik të zgjedhësve nëpërmjet lexuesve të kartës së identitetit, votimin elektronik si dhe numërimin elektronik. Në këto ndryshime janë parashikuar të gjitha procedurat dhe mënyra se si do realizohet kjo gjë, por, gjithashtu, përcaktohet se sa i përket zgjedhjeve të 2019 ai do të zbatohet me projekte pilote, duke zgjedhur bashki të caktuara ku do të aplikohet.

DEPOLITIZIMI

Gjithashtu, në amendimet e hartuara nga ekspertët socialistë janë përfshirë edhe hapat për të bërë kalimin e madh nga një administratë kretjesisht politike zgjedhore në një administratë profesionale dhe mbi të gjitha apolitike. Kështu në këtë projektligj është parashikuar një proces i tërë trajnimit për administrator zgjedhor të certifikuar. Për këtë KQZ-ja zhvillon në mënyrë të rregullt programe trajnimit për shtetasit me të drejtë vote, për kualifikimin e tyre në ushtrimin e detyrës së anëtarit të NJAZ-it, zyrtarit të votimit dhe zyrtarit të numërimit. Programet e trajnimit si zyrtarë zgjedhorë për nëpunësit civilë do të jenë



Komisioni Zgjedhor

GRUPET E NUMËRIMIT

Zyrtarët zgjedhorë të NJAN-it janë individë të kualifikuar në ushtrimin e përgjegjësisë të detyrës, të cilët emërohen nga KQZ-ja, me short, midis personave të trajnuar si administratorë zgjedhorë në sistemin e trajnimit të KQZ-së.

pjesë e kurrikulës së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP), dhe gjithashtu do të jenë të detyrueshme për të gjitha nivelet e nëpunësve. Për gjithë shtetasit me të drejtë vote që nuk janë pjesë e shërbimit civil, pranimi në programet e trajnimit bëhet pas aplikimit individual nga shtetasit që plotësojnë kushtet për pranim. Pas fazës së trajnimeve KQZ harton një bazë të dhënash me gjithë zyrtarët zgjedhor dhe i përdor ata për çdo palë zgjedhje duke përfshirë nivelin e dytë dhe të tretë të komisioneve

zgjedhore. Sa i përket Njësisë Administrimit të Zgjedhjeve anëtarët e saj do të zgjidhen nga partitë politike, por duke marrë vetëm nga lista e zyrtarëve zgjedhorë. Ndërsa për komisionet e qendrës së votimit dhe grupet e numërimit emërimin e anëtarëve do e bëjë KQZ nëpërmjet shortit.

Votimi i emigrantëve Një tjetër risi që sjell ky projektligj ka të bëjë edhe me krijimin e mundësisë për votimin e emigrantëve. Socialistët materializojnë kështu një kërkesë të vazhdueshme të emigrantëve sh-

VOTA E EMIGRANTËVE

Zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë vendit, sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, përfshihen në një zonë unike qendre votimi që i bashkëngjitet qarkut Tiranë, pavarësisht nga numri i tyre dhe regjistrohen me kod unik vendbanimi.

qiptarë, por edhe një premtime të hershëm të partive politike. Për efekt të numërimit dhe përllogaritjes së rezultatit, në këtë projektligj është parashikuar që votat e emigrantëve të njihen si vota për qarkun Tiranë për rastin e zgjedhjeve parlamentare. Zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të votojnë në zgjedhjet për Kuvendin, nga vendi ku jetojnë, nëse kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe nëse kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë. Pas këtij momënti KQZ i dërgon me anë të Postës Shqiptare në një zarf të mbyllur fletën e votimit në adresën e regjistruar si vendbanim në rastin e votimit manual dhe në rastin e votimit elektronik manualin se si një votues mund të votojë.



PD: Amendamentet të njëanshme, PS po minon reformën

Demokratët kanë reaguar dje ndaj publikimit të projektligjit për ndryshimet në Kodin Zgjedhor nga ana e Partisë Socialiste. Oerd Bylykbashi, bashkëkryetar i Komisionit Parlamentar ad-hoc për Reformën Zgjedhore tha dje se me paraqitjen e draftit të njëanshëm të amendamenteve të Kodit Zgjedhor, PS në mënyrë të përsëritur po minon reformën zgjedhore. Sipas tij, ky akt tregon qartë se i vetmi qëllim i PS është të sabotojë reformën zgjedhore. "Parlamenti mund të votojë vetëm amendamente që miratohen nga Komisioni i Reformës Zgjedhore. Veprimi i sotëm i Partisë Socialiste ka si qëllim vetëm prishjen e urave të konsensusit për rregulla loje që pamundësojnë ripërtëritjen e shkeljeve dhe manipulimeve të zgjedhjeve që konstatoi raporti i OSBE/ODIHR në 2017. Reforma zgjedhore ka konstatuar se problemet kryesore të zgjedhjeve janë pasojë dhe përgjigjësi e qeverisë. Asnjë përpjekje nuk është bërë nga qeveria për të zgjidhur problemën e 1,4 milionë letërnjoftimeve që u skadon vlefshmëria deri në ?datën e zgjedhjeve 30 qershor 2019, që përbën shumicën dërrmuese të zgjedhësve aktive", deklaroi Bylykbashi.

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbarimes gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 24.12.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i lli-të për shfitjen e pasurisë së paluajtshme, Arë me sipërfaqe totale 1500 m² me numër pasurisë 6/90, volumni 9, faqe 174, zona kadastrale 1879, e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlerë fillestare në ankand 15.876 (Pesëmbëdhjetmijë e tetëqind e shtatëdhjet e gjashtë) EUR. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 067207580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

"Regjistruan objekte me leje legalizimi afër liqenit dhe në pronësi të kulteve fetare"

Abuzuan me detyrën, KLSH kallëzon në prokurori 4 punonjës të ZVRPP Pogradec

"Kryen regjistrime të pasurive me AMT pa dokumentacion ligjor në sipërfaqe 22000 m²"

POGRADEC

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kallëzuar në Prokurori një ish-regjistruar dhe tre specialistë të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Pogradec. Sipas KLSH-së, 4 personat akuzohen se kanë kryer regjistrime të pasurive me AMT pa dokumentacionin e duhur ligjor në sipërfaqe 22000m², me dokumente të parregullta duke kthyer nga tokë truall e tokë pa fryt në tokë arë, nuk kanë zbatuar kriteret e duhura ligjore për pagesa për detyrime ndaj shtetit me dëm ekonomik në vlerën 52.2 milionë lekë si dhe kanë regjistruar objekte me leje legalizimi afër liqenit dhe mbi truall, në pronësi të kulteve fetare. Gjithashtu, sipas KLSH-së, janë regjistruar objekte të legalizuara në kushtet e konfliktit të interesit dhe falsifikimit, me qëllim tjetërsimin e pronës së shtetit. U konstatuan gjendje 942 aplikime të praktikave me të ardhura të përfuturara pa dhënë shërbimin e futuruar, duke krijuar impakte sociale negative etj. Personat e akuzuar janë: M.SH., me detyrë ish-Regjistruar, A.T., me detyrë specialist hartograf, E.P., me detyrë specialist hartograf dhe S.A.

NJOFTIMI I KLSH-SË

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr.726/1, datë 21.06.2018 miratuar nga kryetari, ka audituar Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, për periudhën 01.06.2015 deri në 01.07.2018. Bazuar në Vendimin nr.183, datë 03.12.2018 të kryetarit për shkelje të dispozitave ligjore të konstatuara, KLSH ka përcjellë për kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec për konsumim të elementëve të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", neni 248 i Kodit Penal, për disa drejtues sepe:

- Në 1 rast ka kryer regjistrimin dhe ka lëshuar certifikatë pronësie në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka nënshkruar aktet zyrtare për pronën e tij, gjithashtu ndërtesa e legalizuar nuk pasqyrohet në imazhin digjital datë 03.07.2014, nuk pasqyrohet në hartën kadastrale, madje koordinatat e genplanit datë 20.03.2018 të lejes legalizimit pasqyrojnë një objekt jashtë parcelës në fjalë.

- Në 1 rast ka ndryshuar zërin kadastral nga tokë arë në tokë truall, me sipërfaqe 16325 m², pasuria nr:254/67, ZK 3665, Hudënisht pa argumente ligjore, në zonën e mbrojtur buzë Liqenit Pogradecit, në mosrespektim të distancës nga liqeni, pa vendim të KKT dhe studim urbanistik për ndërtime, në kushtet kur kjo zonë është përfshirë më parë nga shpronësimet e pronave sipas VKM nr.222, datë 11.03.2015 dhe VKM nr.909, datë 22.12.2014 "Për rehabilitimin e bregut, gjelbërimin dhe ndërtimin e segmentit rrugor Linë-Pogradec".

- Kanë kryer transak-



TRANSAKSIONET

ZVRPP Pogradec në 4 raste ka kryer transakcione mbi pasuritë që janë pjesë e ngastrës së tokës duke lëshuar certifikata pronësie, pasuri mbi të cilën është vendosur kufizim sipas shkresës nr.750/1, datë 16.02.2008 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtës së Konsumatorit, përcjellë në ZVRPP Pogradec me shkresën nr.4776/1, datë 04.03.2008 të ZQRP.

sione mbi pasurinë nr.79 me sipërfaqe 8200 m² tokë arë, e regjistruar me AMTP nr.2250, Alarup, ZK 1008, pa verifikuar elementët e formës dhe përmbajtjes të AMTP 2250, pasi kjo AMTP nuk ka asnjë vullë dhe nënshkrimin e komisionit.

- ZVRPP nuk ka kërkuar pranë KVVTP vlerësimin dhe njohtin e titullit pronësisë, si dhe nuk ka vendosur kufizim tek seksioni "E" të kartelës së pasurisë.

- Kanë regjistruar dhe pajisur me certifikatë pronësie sipas AMTP, pa verifikuar elementët e formës dhe përmbajtjes të akteve administrative, pasi disa AMTP përfshijnë sipërfaqe në zërin "arë", ku në fakt ato janë "kullotë", të cilat nuk janë objekt i ligjit për tokën bujqësore në ZK 1387, Çerravë, me sipërfaqe 1500 m² "arë" ku në fakt është "kullotë", mbi bazën e të cilave janë kryer padrejtësisht dëmshpërblimet ndaj poseduesve.

- ZVRPP Pogradec në 2 raste, nuk ka arkëtuar vlerën 1,975,480 lekë që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit, që vijjnë nga mos arktëtimi i të ardhurave nga mos llogaritja e tarifës së takses ndikimi në infrastrukturë gjatë regjistrimit të lejeve të ndërtimit dhe legalizimit, penaliteteve për daljen jashtë lejes së ndërtimit.

- ZVRPP Pogradec gjatë

periudhës 2015-01.06.2018 ka qenë palë në 176 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur dhe të palës së tretë, nga të cilat ka qenë në mungesë në 139 raste, ndërkohë në 37 raste nuk ka ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit.

- ZVRPP Pogradec nuk ka zbatuar procedurat lidhur me zbatimin e afateve ligjore për kryerjen e shërbimeve të futuruar, ndaj qytetarëve, pasi administrimi i praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduar të cilat prej 4 vitesh deri në 01.06.2018 arrijnë në rreth mbi 942 aplikimeve praktika me të ardhura të përfuturara pa dhënë shërbimin e futuruar, mos administrimin në arkiv të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transpar-

DURRËS - Gjykata e Durrësit ka lënë në burg dy policët privatë, të cilët u arrestuan tri ditë më parë për shpërdorim detyrë në lidhje me grabitjen e shumë prej 7.5 milionë lekësh të reja të Drejtorisë së Patentave. Ngjarje kjo endodhur pak ditë më parë në Shkozet. Togat e zezat të qytetit bregdetar vlerësu-

PROCESE GJYQËSORE

Sipas raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Pogradec gjatë periudhës 2015-01.06.2018 ka qenë palë në 176 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur dhe të palës së tretë, nga të cilat ka qenë në mungesë në 139 raste, ndërkohë në 37 raste nuk ka ndjekur të gjitha shkallët e gjyqësorit.

encës së punës ndaj publikut dhe mosfunksionimit e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve.

- Në regjistrimin e lejes së legalizimit për objektin "Godinë e kombinuar 9 Kate + Papafingo+ Bodrum" në pronësi të "K" Sh.p.k, nga verifikimi i kontratave të porosisë me palët e tretë rezultoi se në çmimin e shitjes janë futur dhe sipërfaqet e përbashkëta, ndërkohë që nga firma ndërtoese nuk është paguar taksa e kalimit të pronësisë për sipërfaqen totale 391 m², që llogaritet në vlerën 138,826 lekë që përbën dëm ekonomik dhe të ardhura të munguarja për buxhetin e shtetit, gjithashtu në kartela nuk është regjistruar sipërfaqja e përbashkët.

- Në 14 raste për pasuritë në pronësi të "K" Sh.p.k, nga verifikimi i veprimeve në kartelat e pasurisë rezultoi se ka vepruar duke liru pasuritë nga sekuestro e vendosur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë me shkresën nr:25763 prot., datë 01.11.2016, për shlyerjen e detyrimit në vlerën 50,123,376 lekë, edhe pse kontratat e porosisë dhe më pas kontratat e shitjes janë regjistruar më pas në kohë

se sa vendosja e urdhër sekuestros.

- Në 2 raste ZVRPP Pogradec për pasuritë nr.3/180+1-22, vol.39, fq.112 dhe nr.3/180+1-41, vol.39, fq.131, ka proceduar me lirim e pasurive nga sekuestro, dhe ka regjistruar kontratat e shitjeve përkatësisht, pa asnjë dokument ligjor që justifikon heqjen e sekuestros, apo kontratë porosisë regjistruar më parë në kohë nga vendosja e urdhër sekuestros. Të gjitha veprimet më sipër kanë sjellë si pasojë tjetërsimin e pasurive tek palët e tretë dhe mos shlyerjen e detyrimit prej 50,123,376 lekë.

- Në 4 raste ka kryer transakcione mbi pasuritë që janë pjesë e ngastrës së tokës duke lëshuar certifikata pronësie, pasuri mbi të cilën është vendosur kufizim sipas shkresës nr.750/1, datë 16.02.2008 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtës së Konsumatorit, përcjellë në ZVRPP Pogradec me shkresën nr.4776/1, datë 04.03.2008 të ZQRP.

- Në 1 rast ZVRPP Pogradec ka regjistruar leje legalizimi për objekt informal, ku një pjesë e sipërfaqes së truallit të objektit të legalizuar bie mbi truall të objekteve të kultit "Truall" me sip.2520 m² në pronësi të Komunitetit Mysliman.

Për M.SH. me detyrë ish Regjistruar, A.T. me detyrë Specialist Hartograf, E.P. me detyrë Specialist Hartograf, S.A. me detyrë të cilët në mospërbushje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave ligjore, kanë konsumuar elementët e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, KLSH ka përcjellë me shkresë nr:726/18 prot., datë 17.12.2018 indicie për kallëzim penal Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse.

SHKURT

Prokurori Progonati në "sitën" e vetingut, KPK:

Justifikon pasurinë

TRIANE - Alfred Progonati, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme ka kaluar dje në "sitën" e vetingut. Gjatë seancës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që drejtohej nga trupa gjyqësore Pamela Qirko, Genta Tafa, Xhensila Pine, u verifikua pasuria e prokurorit.

Duke iu referuar të dhënave të ILDKPKI, KPK konstatoi se Progonati ka burime ligjore që justifikojë pasurinë. Sipas KPK, prokurori ka një apartament 126 m² në Tiranë, ndërsa e ka blerë me një shumë prej 70 mijë eurosh.

Misteri, gjendet i mbytur në një kanal 45-vjeçari

SARANDE - Një person është gjetur mbrëmë i mbytur në një kanal në fshatin Vriun të Bashkisë së Finiqit. Trupi i pajetë është parë nga kalimtarët, të cilët kanë njoftuar menjëherë policinë. Mësohet se trupi është nxjerrë me vështirësi nga kanali, pasi ishte i mbuluar nga ferrat. Dyshohet se viktima është rreth 45 vjeç dhe mund të jetë mbytur tri ditë më parë. Kufomës i janë gjetur edhe fije peshkimi dhe dyshohet se ka qenë në kanal për të peshkuar ngjalla. Ndërkaq, policia e Sarandës po vijon hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Shkoi për të punuar si berber, humb jetën 26-vjeçari shqiptar

ANGLI - Një 26-vjeçar, i cili u largua para një muaji nga Shqipëria drejt Anglisë për një jetë më të mirë ka humbur jetën. Dy ditë më parë, Franci Çoku nga Divjaka tekta po kthehej nga puna është pikasur nga policia britanike dhe në tentativë për t'i shpëtuar arrestimit, i riu ka pësuar atak kardiak. Ai kish të lënë Shqipërinë për të vijuar profesionin e berberit në një shtet si Anglia, por ky rrugëtim përfundoi në fatalitet për të riun shqiptar. Ndërkaq, mbetet problem kthimi i trupit të 26-vjeçarit në vendlindje, pasi duhet të sigurohet më parë një shumë e konsiderueshme financiare.

U kap i plagosur, shqiptarë arratiset nga paraburgimi

GREQI - Në orët e para të mëngjesit të djeshëm, një shqiptar është arratisur nga qelitetë e paraburgimit në Greqi. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 04:20 në një rajon policie në Menidhi. Policia bëri të ditur se ai ishte arrestuar i plagosur pas një grabitje me dhunë në një postë greke me 27 nëntor në Vila Atikise, ndërsa po punohej për kapjen e shqiptarit.

Grabitja e 7.5 mln lekëve në Shkozet, lihen në burg dy policët privatë

an të ligjëshëm arrestimin sh-tetasit Fejz Sakaj dhe të Asrit Gjatës, duke vendosur ndaj tyre masën e sigurisë "Arrest me burg". Ndërkohë që pas vënies në pranga dy policët privatë deklaruan

gjatë marrjes në pyetje nga policie se janë të pafajshëm për grabitjen e parave në blindin që po i transportonte në një bankë të nivelit të dytë, pasi 3 personat e maskuar u vunë armët në kokë.

KESHILLI BASHKIAK PROJEKTVENDIMET

"4 muaj afat për të lidhur kontratë me bankën, në të kundërt skualifikoheni"

Zbardhet projektvendimi, fituesit që do të marrin shtëpi me kredi të butë

Këshilli Bashkiak: 549 familje të tjera në listën e pritjes

Voltiza Duro

Në datën 21 dhjetor të këtij viti, do të mbahet mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës ku pritet miratimi i listës fituese të 500 familjeve që do të përfitojnë shtëpi me kredi të butë. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot projektvendimin për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë", për vitin 2018. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezultojnë se nga 1082 aplikime, plot 1005 të tilla janë të rregullta dhe plotësojnë kriteret për përfitim të kredisë së butë për shtëpi. "77 aplikime janë skualifikuar, nga të cilat 59 kanë rezultuar të parregullta dhe/ose me mangësi në dokumentacion, 6 aplikime për shkak se të ardhurat familjare rezultojnë mbi limitin e përcaktuar në udhëzuesin operacional, dhe 12 aplikime kanë rezultuar nën limitin e përcaktuar në udhëzuesin operacional", theksohet në projektvendim.

FITUESIT DHE LISTA E PRITJES

'Gazeta Shqiptare' zbardh sot tabelën me fituesit (bazuar në strukturat korresponduese të shtëpive); të skualifikuarit dhe ata që kanë kaluar në listën e pritjes. Përkatesisht 36 persona kanë fituar garsonierë; 337 kanë fituar shtëpi 1+1 me kredi të butë; 81 të tjerë do të marrin shtëpi 2+1 dhe vetëm dy familje do të paguajnë një shtëpi 3+1 me kredi të butë. Familjet përfutuese do të kenë një afat prej 4 muajsh, i cili fillon nga momenti i njoftimit që do të kryejë Bashkia Tiranë, që të paraqiten pranë bankës për lidhjen e kontratës. Në rast se familjet përfutuese nuk respektojnë këtë afat, atëherë kjo përbën shkak që banka të vijojë me familjet e vendosura në listën e pritjes, e cila do t'i vendoset në dispozicion nga struktura përkatese e Bashkisë Tiranë. "Komisioni vendosi se pjesa prej 549 familjeve të vendosen në listën e pritjes,



Faksimile e njoftimit



LISTA E PRITJES

"Komisioni vendosi se 549 familje të vendosen në listën e pritjes që do të jetë e zbatueshme për rastet kur fituesit nuk paraqiten, heqin dorë, nuk pranojnë dhe/ose refuzojnë që të lidhin kontratën përkatëse me bankën të përzgjedhur nga Bashkia Tiranë"- thuhet në relacion.

SYNIMI

Programi për "Subvencionimin e interesave të kredisë" synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës, nëpërmjet kredive hipotekore me kushte lehtësuese, e cila jepet për strehim dhe kur një pjesë e interesave të kredisë subvencionohet nga Bashkia Tiranë.



Kryebashkiaku Erion Veliaj, gjatë një mbledhjeje të Këshillit Bashkiak të Tiranës

77

TË SKUALIFIKUAR

"77 aplikime janë skualifikuar, nga të cilat 59 kanë rezultuar të parregullta dhe/ose me mangësi në dokumentacion, 6 aplikime për shkak se të ardhurat familjare rezultojnë mbi limitin e përcaktuar në udhëzuesin operacional, dhe 12 aplikime kanë rezultuar nën limitin e përcaktuar në udhëzuesin operacional", theksohet në projektvendim.

4

MUJ AFAT

Familjet përfutuese do të kenë një afat prej 4 muajsh, i cili fillon nga momenti i njoftimit që do të kryejë Bashkia Tiranë, që të paraqiten pranë bankës për lidhjen e kontratës. Në rast se nuk respektohet ky afat, kjo përbën shkak që banka të vijojë me familjet e vendosura në listën e pritjes.

e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore.

SHQYRTIMI DHE SKUALIFIKIMET

Në total, në fazën e parë, pranë Njësi Administrative kanë plotësuar Formularët e Strehimit 2514 aplikues. Në përfundim të seleksionimit dhe regjistrimit të formularëve të vlefshëm, Drejtoria e Strehimit Social ka shpallur fitues të fazës së parë, 2256 aplikues, si dhe ka skualifikuar 258 aplikime. Pas njoftimit të aplikantëve fitues, si dhe pas përfundimit të shqyrtimit të ankimeve, është vijuar me zbatimin e fazës së dytë të këtij programi, i cili ka filluar me shpalljen e njoftimit publik drejtuar familjeve/aplikantëve përfutues të fazës së parë, për dorëzimin e dokumentacionit të përcaktuar në udhëzuesin operacional. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, me anë të shkresës me nr. 27385 prot., datë 13.07.2018, ka njoftuar

aplikantët në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe afatin e depozitimit të tyre pranë Bashkisë Tiranë. "Në përfundim të afateve përkatëse, struktura përgjegjëse e Bashkisë Tiranë (Drejtoria e Strehimit Social) ka administruar dhe shqyrtuar në total një numër prej 1877 aplikime, nga të cilat ka skualifikuar për mungesë dhe/ose problematikë dokumentacioni 795 aplikime, 3 aplikime të depozituara nëpërmjet postës së thjeshtë, të cilat janë depozituar përtej afatit të përcaktuar për depozitimin e aplikimeve, si dhe 14 aplikime janë përcjellë nga Këshilli Bashkiak, të cilat nuk janë shqyrtuar nga Drejtoria e Strehimit", thuhet në relacionin e Këshillit Bashkiak. Ky i fundit i ka paraqitur për kompetencë Drejtorisë së Strehimit Social, gjithsej 14 aplikime, të cilat nuk janë marrë për shqyrtim për vendimmarrje paraprake.

	Nr.i aplikanteve	Shuma që përfitojnë	Totali
Skualifikuar	77		
Gasionere	36	4,456,850.00	160,446,600.00
1+1	337	5,348,220.00	1,802,350,140.00
2+1	81	7,130,960.00	577,607,760.00
3+1	2	8,913,700.00	17,827,400.00
Listë pritje	549		2,839,013,450.00
Totali	1082		5,397,245,350.00

e cila do të jetë e zbatueshme për rastet kur familjet e shpallura fituese nuk paraqiten, heqin dorë, nuk pranojnë dhe/ose refuzojnë që të lidhin kontratën përkatëse me institucionin financiar bankar të përzgjedhur nga Bashkia

Tiranë"-thuhet në relacion. Programi social i strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë" synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës, nëpërmjet kredive hipotekore me kushte lehtë-

suese, e cila jepet për strehim dhe kur një pjesë e interesave të kredisë subvencionohet nga Bashkia Tiranë. Ky program shërben për strehimin e familjeve dhe individëve që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën



Projektvendimi: Aplikimi i taksës sipas sistemit mbi bazë vlere fillon në janar 2019

UKT, agjenti i ri i mbledhjes së taksës së pasurisë së paluajtshme

Taksapaguesit duhet të vetëdeklarojnë të dhënat

Voltiza Duro

Shoqëria aksionare Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, pritet të marrë rolin e agjentit të mbledhjes së taksës së pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", që përdoret apo shfrytëzohet për qëllime banimi në Bashkinë e Tiranës. Ky vendim pritet të miratohet këtë të premte gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të Tiranës. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot projektvendimin në të cilin theksohet se taksapaguesit brenda 4 muajsh duhet të paraqiten pranë zyrave të UKT-së për të kryer vetëdeklarimin mbi të dhënat e pasurisë së paluajtshme që kanë në pronësi apo në përdorim. "Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë" sha me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës për ndërtesën, njofton të gjithë taksapaguesit që brenda një afati 4 muajor duhet të paraqiten pranë zyrave të kësaj shoqërie për të kryer vetëdeklarimin mbi të dhënat e pasurisë së paluajtshme që ka në pronësi apo në përdorim", theksohet në projektvendim. Me kalimin e afatit të përcaktuar, shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Tiranë" sha do të fillojë procesin e përpunimit të informacionit të vetëdeklarimit të taksapaguesit për qëllim të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore mbi taksën e pasurisë së paluajtshme. Informacioni duhet të përpunohet brenda një periudhe kohore jo më të gjatë se 3 muaj.



këtij procesi me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë. "Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë" sha marr masat për krijimin e bazës së të dhënave për pasuritë e paluajtshme që përdoren/shfrytëzohen për qëllime banimi, duke përdorur dhe siguruar të gjithë informacionin nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI, si dhe çdo entitet tjetër shtetëror apo privat. Shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Tiranë" sha në rolin e agjentit të mbledhjes së taksës së

pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", që përdoret apo shfrytëzohet për qëllime banimi përfiton një komision prej 5 (pesë) % mbi të ardhurat e arëktuara nga taksat e ndërtesës", theksohet në projektvendim.

PROCESI
Me kalimin e afatit të përcaktuar, shoqëria "Ujësjetllës Kanalizime Tiranë" sh.a. do të fillojë procesin e përpunimit të informacionit të vetëdeklarimit të taksapaguesit për qëllim të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore mbi taksën e pasurisë së paluajtshme.

TAKSA E PASURISË

Me ndryshimet e fundit ligjore, të datës 1 Prill 2018, taksa e ndërtesës ka marrë një tjetër vlerësim, duke u mbështetur tek vlera e banesave. Niveli i taksës i shprehur në përqindje si për ndërtesat që përdoren për banim në masën 0.05% edhe për ndërtesat që shfrytëzohen për veprimtari ekonomike në masën 0.2%, aplikohet mbi vlerën e ndërtesës (çmimi i shumëzuar me sipërfaqe). Për këtë qëllim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë, në bashkëpunim me institucione të tjera qendrore si, OSHEE, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ZVRPP etj., është në proces për finalizimin e ngritjes së bazës së të dhënave, krijimin e Kadastrës Fiskale si informacioni bazë i domosdoshëm për përllogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave nga taksat e ndërtesës. Për kategorinë e ndërtesave që shfrytëzohen për banim, aplikimi i taksës sipas sistemit mbi bazë vlere, do të fillojë në janar 2019.

MASAT E GJOBAVE

Masat e sanksionimit me gjobë për kundërvajtjet administrative të parashikuara në këtë vendim:

- Për kundërvajtjet në fushën sigurisë dhe rregullave të hapësirës publike të parashikuara në nenin 7 dhe nenin 8, Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1 000 (një mijë) deri në 20 000 (njëzetmijë) lekë.
- Për kundërvajtjet të parashikuara në nenin 9, Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 1000 (një mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
- Për kundërvajtjet të parashikuara në nenin 10, Policia Bashkiake vendosë gjobë nga 2 000 (dy mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

Për kundërvajtjet administrative në fushën e mjedisit, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës, do të vendosë gjobë:

- Në masën 5 000 (pesëmijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 11 dhe për çdo rast të përsëritur kjo masë do të dyfishohet deri në vlerën maksimale prej 20 000 (njëzetmijë) lekë;
- Në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për konstatim të shkeljeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 11;
- Në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për konstatim të shkeljeve të parashikuara në pikën 3 të nenit 11.

Për kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit vendosë gjobë:

- Në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në pikën 1 të nenit 12;
- Në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 12;

Për kundërvajtjet administrative nga pronarët/kujdestarët, në fushën e zbatimit të normave detyruese të sjelljes së kafshëve/shpendëve, në njësitë individuale të banimit, ambientet në bashkëpronësi dhe hapësirat publike, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës, do të vendosë gjobë:

- Në masën 1 000 (njëmijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 13, masë e cila dyfishohet në rast të përsëritjes së shkeljes brenda një periudhe 3 (tre) mujore nga pronar/kujdestari i kafshëve/shpendëve;
- Në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, për konstatimet e parashikuara në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 13, masë e cila do të jetë e dyfishuar në rast të përsëritjes së shkeljes nga pronar/kujdestari i kafshëve/shpendëve;

*Pavarësisht parashikimeve të pikës 4 dhe 5 të këtij neni, kur Policia Bashkiake konstaton në kryerje e sipër kundërvajtjen në fushën e infrastrukturës publike, vendos menjëherë dënimin me gjobë sipas parashikimeve të kësaj pike dhe në çdo rast njofton Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit për përllogaritjen e dëmit dhe shpërbllimin e tij nga kundërvajtësi.

*Në këtë rast Policia Bashkiake vendos në dispozicion të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit një kopje të procesverbalit të gjobës.

Zbardhen masat e gjobave për kundërvajtjet administrative

Gjatë mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak pritet të miratohet edhe projektvendimi për Kontrollin e Territorit dhe Përcaktimin e disa Kundërvajtjeve administrative dhe sanksionit që vendoset për to në Bashkinë e Tiranës. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot masën e gjobave që duhet të paguajnë qytetarët në raste të shkeljes së rregullave. Ky vendim ka si synim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe normative sjeljeje, si dhe standarde të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt juridik, individ fizik që ushtrojnë aktivitetin e tyre apo që jetojnë në Bashkinë e Tiranës. "Vendimi përcaktion kundërvajtjet administrative për shkeljen e rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës së bashkëjetesës shoqërore në fushën e sigurisë publike, qetësisë dhe moralit publik, mbrojtjes së mjedisit, hapësirës publike, si dhe procedurën e konstatimit të kundërvajtjes dhe vendosjes së sanksioneve administrative për to", thekset në projektvendim. Qëllimi i këtij vendimi është mbrojtja e rendit dhe qetësisë, mbrojtja e pronës publike/shtetërore, garantimi dhe zbatimi i rregullave, normave detyruese të higjienës, shëndetit publik dhe etikës të përcaktuara në legjislaclacionin në fuqi dhe aktet normative të Bashkisë së Tiranës, duke u angazhuar në ndërgjegjësimin nga të gjithë, për respektimin e rregullave të bashkëjetesës shoqërore, nëpërmjet përcaktimit të kundërvajtjeve administrative që cenojnë këto rregulla në fushën e sigurisë, qetësisë, moralit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe hapësirës publike.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA nr. 1/355, e llojit "Trruall dhe Ndërtesë" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur në Ish-Fushën e Aviancionit) me sipërfaqe të trruallit 273 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 200.2 m², Zona Kadastrale 8220, Vol. 23, Fq. 28, e regjistruar në Regjistrin Hipotekeq Nr. 18, datë 07.01.2011 pranë Z.V.R.P.P TIRANË, në pronësi të Znj. DENKË SEFERI.

ÇMIMI 36.389.985,28 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 02.01.2019.

CEL: 0684026566; 069326286.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përbërimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të II (dytë), për shitjen e pasurisë ULLISHTË, me sip.3.400 m², Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Selfer Skragaj, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **1.904.000 (një milion e nëntëqind e katër mijë) LEKË.**

Ankandi do të zhvillohet më datë 16.01.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbërimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vasa Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.teléfono 042320227, email: glvinth@hotmail.com.



Leksioni i hapur, diskutim mbi bilancin e qeverisjes vendore dhe transparencën

Voltiza Duro

Politologu i njohur në "Luarasi": Jeni të mirëpritur për praktikë

Krasniqi: Fakulteti i Drejtësisë, ndër më të mirët në vend

Universiteti "Luarasi" vazhdon të ndjekë traditën e leksioneve të hapura duke sjellë pranë studentëve ekspertët më të mirë. Këtë të martë, i ftuar në Fakultetin e Drejtësisë ishte Afrim Krasniqi, politolog i njohur, njëkohësisht drejtues i Institutit të Studimeve Politike. Ai diskutoi me studentët e "Luarasit" mbi bilancin e qeverisjes vendore në Shqipëri, veçanërisht në ato parime që kanë interes qytetarët.

FTESA PËR BASHKËPUNIM

Rezana Konomi, dekan e Fakultetit të Drejtësisë në këtë institucion të arsimit të lartë, tha se do të ishte bashkëpunim shumë i mirë nëse studentët e "Luarasit" do të jenë pjesë e praktikave në Institutin e Studimeve Politike. "Nëse do të kishim bërë ndonjë marrëveshje përtej leksioneve të hapura, me Institutin e Studimeve Politike, ne mund t'u mundësonim studentëve që kanë ambicie, të jenë pjesë e sondazheve që ju bëni, të jenë pjesë e mbledhjes së statistikave. Këto më pas mund t'i përdorin për detyrat, projektet apo esetë e tyre që mund të bëjnë në të ardhmen", tha Konomi gjatë leksionit të hapur. Më tej, Krasniqi ftoi studentët e interesuar që të bëhen pjesë e projekteve në kuadër të praktikave për t'u përgatitur profesionalisht për të ardhmen. "Unë do të dërgoj edhe projektet që ne kemi, dhe më tej, bazuar në temat do të vijnë grupet e studentëve që kanë interes. Individët që dëshirojnë të bëjnë praktikë, ne do t'i ndihmojmë edhe që të shkojnë të ndjekin deputetë të caktuar. Kushdo nga ju që do të ketë interes, është i mirëpritur!", i tha politologu studentëve të Drejtësisë në "Luarasi".



FTESA

"Unë do të dërgoj edhe projektet që ne kemi dhe më tej, bazuar në temat do të vijnë grupet e studentëve që kanë interes. Individët që dëshirojnë të bëjnë praktikë, ne do t'i ndihmojmë edhe që të shkojnë të ndjekin deputetë të caktuar. Kushdo nga ju që do të ketë interes, është i mirëpritur!", - u tha politologu studentëve të Drejtësisë në "Luarasi".

QEVERISJA VENDORE

Drejtuesi i Institutit të Studimeve Politike ka diskutuar me studentët e Drejtësisë edhe mbi transparencën e llogaridhënien e organeve të qeverisjes vendore në vendin tonë. Bilanci realizohet me synim për të analizuar se cilat janë hapat për të përmirësuar qeverisjen vendore dhe për të përfshirë universitetet në këtë proces. Krasniqi e vlerësoi Fakultetin Juridik të Luarasit si një ndër fakultetet më të mira në vend, me kapacitete në interes për Institutin e Studimeve Politike. "Është e rëndësishme që të bëjmë një bilanc të gjendjes për të parë se çfarë ka funksionuar mirë dhe çfarë ka funksionuar gabim dhe kush është roli që mund të luajnë qendrat akademike universitare, siç është uni-

versiteti "Luarasi" në përmirësimin e bazave ligjore, në përmirësimin e praktikave të mirëqeverisjes dhe në përfshirjen e studentëve dhe stafeve pedagogjike në këtë lloj procesi. Instituti i Studimeve Politike dhe universiteti "Luarasi" kanë rënë dakord për të bërë një shkëmbim eksperiencash, për shkak se në këtë universitet gjendet një nga fakultetet juridike më të mira në Shqipëri dhe si i tillë ka kapacitete dhe interesa për ne, tema të cilat ne i kemi", tha Krasniqi. Në kuadër të kombinimit të teorisë me praktikën, universiteti "Luarasi" do të vijojë me leksionet e hapura duke sjellë ekspertët më të mirë për praktikë. Ofrimi i praktikave të tillë bashkëkohore synon formimin e liderëve të së ardhmes, të denjë për tregun e punës.

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: INVITATION TO BID
"RECONSTRUCTION OF KINDERGARTEN IN GUERRILE QUARTER, SHKODER CITY"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked INVITATION TO BID "RECONSTRUCTION OF KINDERGARTEN IN GUERRILE QUARTER, SHKODER CITY" to the address below.

For more details please refer to the link below:

http://procurement-notice.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=52278

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 11 January 2019, at 14:00 hrs

Address for Communication and offers' submission:

United Nations Development Programme Albania
Str. "Skënderbej", Gurten Center, 2nd floor,
Tirana, Albania
Fax.No: + (355) 4 225 02 86
E-mail: procurement.al@undp.org

Letra e presidentit amerikan për homologun kosovar. Reagimet...

Trump, Thaçit: Ju pres me Vuçiç në SHBA për marrëveshjen historike

"Dështimi i saj do të ishte kthim tragjik mbrapa"

Presidenti amerikan, Donald Trump, fton presidentin e Kosovës dhe atë serb për të arritur një marrëveshje historike pajtimi në shtëpinë e bardhë. "Unë i mirëpres përpjekjet tuaja aktuale për pajtim me Serbinë. Dështimi për të përfutur nga kjo mundësi unike, do të ishte një kthim tragjik mbrapa, sepse një mundësi tjetër marrëveshje paqësore gjithëpërfshirëse, vështirë se do të mund të përsëritet për një kohë të gjatë", i shkruan presidenti Trump, Hashim Thaçit. Presidenti amerikan shton se nxit dhe liderët e Kosovës që ta shfrytëzojnë këtë moment unik, për të folur me një zë të vetëm gjatë negociatave për paqe, dhe të përmbahen nga veprimet, të cilat mund ta vështirësojnë arritjen e marrëveshjes. Pasi përmend se sa kanë investuar Shtetet e Bashkuara për suksesin e Kosovës, si një shtet i pavarur dhe sovran, ai shton se është i gatshëm të ndihmojë sërish shtetin më të ri evropian për të arritur një marrëveshje të balancuar interesash. "Unë pres që në Shtëpinë e Bardhë t'ju mirëpres Ju dhe Presidentin Aleksandër Vuçiç, për të festuar atë që do jetë një marrëveshje historike", përfundon letrën

PRESIDENTI AMERIKAN

Presidenti amerikan nxit edhe liderët e Kosovës që ta shfrytëzojnë këtë moment unik për të folur me një zë të vetëm gjatë negociatave për paqe dhe të përmbahen nga veprimet, të cilat mund ta vështirësojnë arritjen e marrëveshjes. Pasi përmend se sa kanë investuar Shtetet e Bashkuara për suksesin e Kosovës si një shtet i pavarur dhe sovran, ai shton se është i gatshëm të ndihmojë sërish shtetin më të ri evropian për të arritur një marrëveshje të balancuar interesash.



Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump dhe Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

DAÇIÇ KUNDËR HARADINAJT

Ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç ka komentuar sjelljen e kryeministrit Ramush Haradinaj. Ai theksoi se Haradinaj nuk do kompromis. "Ata duan të sjellin situatën në një fazë të re në të cilën ata nuk do të flasin më Mogherinin, sepse ata janë të pakënaqur me Brukselin dhe po kërkojnë që Shtetet e Bashkuara të përfshihen në dialog. Duke u ndalur tek takimi që pati dje Haradinaj me përfaqësuesen e BE-së, Federica Mogherini, që u zhvillua në Bruksel, Daçiç tha se ata nuk kishin asgjë për të folur me gazetarët.

e tij drejtuar Thaçit presidenti i SHBA-ve. Sakaq ka qenë presidenti kosovar ai që ka publikuar letrën ndërsa shkruan; "Liria dhe pavarësia e Kosovës, janë rezultat i

luftës sonë të drejtë dhe përkrahjes së aleatëve tanë strategjikë ndërkombëtarë. Realizimi i synimeve tona për anëtarësim në NATO, BE dhe OKB është i pamundur pa

përkrahjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare. Kosova është e bekuar që gëzon mbështetjen e palëkundur të SHBA-ve dhe të popullit amerikan. Bash-

këpunimi dhe miqësia jonë është e përhershme dhe reciproke. Mirëpo, ne duhet të dimë ta ruajmë dhe forcojmë këtë partneritet që kemi. Respekti dhe ndihma duhet të jenë

reciproke dhe jo të njëanshme. Prandaj, është detyrim ynë që t'i përgjigjemi pozitivisht thirrjeve dhe kërkesave miqësore, që vijnë nga SHBA-të".

Mali i zi: Edhe Kosova me ushtri, por procesi gradual

Zyrtarë të Malit të Zi thonë se formimi i Ushtrisë së Kosovës duhet të jetë një proces gradual dhe të kontribuojë në stabilitetin e rajonit. Ministri i Punëve të Jashtme, Srgjan Darmanoviç, ka thënë se as Mali i Zi por as NATO asnjëherë nuk kanë kundërshtuar të drejtën e çdo vendi që të ketë ushtrinë e vet. "Sekretari i NATO-s paralajmëroi që ky proces të jetë gradual, i hapur, gjithëpërfshirës dhe të sjell stabilitet në rajon, në mënyrë që bashkëpunimi i NATO-s me Kosovën të vazhdojë. Kështu që mendoj se kjo është një qasje realiste të cilën e kemi theksuar disa herë deri më tani" ka thënë Darmanoviç.



MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME TË MALIT TË ZI

Ministri i Punëve të Jashtme, Srgjan Darmanoviç, ka thënë se as Mali i Zi, por as NATO asnjëherë nuk kanë kundërshtuar të drejtën e çdo vendi që të ketë ushtrinë e vet.

Papa Françesku: Vetë udhëheqësit nacionalistë po nxisin homofobinë

Papa Françesku dënoi udhëheqësit nacionalistë të cilët fajësojnë emigrantët për problemet në vendet e tyre, pasi, siç tha, janë vetë ata që po nxisin mosbesimet në shoqëri përmes fitimeve të pandershme dhe politikave ksenofobike dhe raciste. Papa, 82-vjeçar, i cili iu doli në mbrojtje emigrantëve gjatë gjithë papatit të tij, i bëri këto komente në mesazhin e tij për Ditën Botërore të Paqes të Kishës Katolike. Letra iu dërgohet krerëve të shteteve dhe qeverive si dhe organizatave ndërkombëtare. Mesazhi i Papës vjen në kohën kur emigracioni është një nga çështjet më të diskutueshme në vende të ndryshme si: Shtetet e Bashkuara, Italia, Gjermania dhe Hungaria. "Adresimet politike që



tentojnë të fajësojnë emigrantët për çdo të keqe dhe privojnë shpresën nga të varfrit, janë të papranueshme" ka shkruar Papa në letër, por nuk ka përmendur konkretisht ndon-

jë vend apo udhëheqës. Ai tha se në kohët e sotme "po shënojnë një klimë të mosbesimit e rrënjësor në frikën ndaj të tjerëve ose të huajve, ose ankthit për sigurinë personale".

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 19 Dhjetor 2018 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Kryeministri tregon çfarë i shkruajti një zonjë...
- Braçe heq kostumin e politikanit dhe na shfaqet si berber
- Babai i Meghan Markle i shtrin dorën së bijës, apel për ribashkim
- Veli aj flet për djalin: Ia preva kërthizën vetë. I ndërroj pelenat

Zaimina Vasjari poston foto me fustanin seksi, ku i shpërthen gjoksi



U shpëtoi jetën 20 fëmijëve, shpallet "hero" shqiptari në Suedi



Ja talentet që na bëjnë krenarë jashtë vendit



Jemi ngado! Viti 2018, shqiptarët 'pushtojnë' botën!

Rita Ora e Dua Lipa janë vetëm fillimi, shtohet lista e 'yjeve' me gjak shqiptar

Nga aktorët e "Taken" e "Bad Boys" te këngëtarja që kryeson në top-listat e huaja, ja ata që na bëjnë krenarë jashtë vendit

Jemi ngado! Viti 2018, shqiptarët 'pushtojnë' botën!

Rita Ora e Dua Lipa janë vetëm fillimi, shtohet lista e 'yjeve' me gjak shqiptar

Pamela Aliaj

Për pak ditë përmbillet edhe ky vit e nëse kthejmë për një çast kokën pas e shohim gjithë ndodhitë e këtij viti, mund të themi me plot gojë se ky vit ka qenë mjaftueshëm i mbarë për shqiptarët. Kur flasim për suksesin e artistëve shqiptarë nëpër botë, mund të themi se 2018-ta është një ndër vitet që na ka bërë më shumë krenarë se kurdoherë. Emra të njohur si Rita Ora, Dua Lipa, Bebe Rexha, Albert Stanaj apo Era Istrefi, kanë spikatur këtë vit nëpër botë me zërat e tyre të veçantë dhe origjinën që identifikohet me një fjalë "shqiptar". Por duket se kësaj liste po i shtohen të tjerë artistë që po ngjiten shkallët e suksesit jashtë kufijve tanë. Këtë e themi duke u bazuar në disa nga lajmet e ndryshme të nxjerra nëpër botë ku kanë qenë vetë shqiptarët që kanë kryesuar me talentin e tyre në fusha të ndryshme. Sado të mundohemi, jemi të sigurtë se nuk do mund t'i nxjerrim të gjithë që janë shpërndarë nëpër cepat me orare të ndryshme të lindjes apo perëndimit të diellit. Ndërkaq në këto muajt e fundit mund të përmendim disa prej tyre të cilët e kanë ngritur më tej emrin shqiptar nëpër mediat e huaja.

KLEPTO:

Ndër të përmendim reperin shqiptar, i cili jeton në Amerikë e është pjesë e TBA-së së Unnikatilit Klepto. Ai do të jetë figurant në klipin e ri të një emri shumë të famshëm. Bëhet fjalë për klipin e ri të reperes së njohur amerikane Cardi B, latinia më e famshme që po bën zhurmë në gjithë botën me këngët e saj. Është Klepto ai që i ka publikuar në profilin e tij në Instagram disa fotografi nga seti i xhirimeve me reperen, ndërsa ai ka një rol shumë interesant me një armë në dorë. Se për çfarë bëhet fjalë saktësisht e shohim sapo të publikohet klipin i saj!

LEO KRKUTI:

Një tjetër talent shqiptaro-amerikan është Leo Krkuti. Një djalë 22-vjeçar i lindur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ka spikatur për talentin e tij në muzikën Pop si dhe tekst-shkrues. Në vitet e fundit ai ka bashkëpunuar me studiot muzikore më në zë të Nju-Jorkut dhe ka arritur të jetë në Billboard-et e magjishme të Times Square-it. Irri-ritur me kulturën, historinë dhe vlerat shqiptare në familje ku flitet shqip ai këtë verë vendosi t'ia dedikojë Shqipërisë këngën më të re "What I like". Leo ka publikuar një album, dy debutime, disa single-a, muzika, e të cilave është pëlqyer jashtëzakonisht shumë duke kaluar mbi 100,000 pëlqime në platformat e mëdha si I-tunes dhe Spotify.

ARBEN BAJRAKTARAJ:

Arben Bajraktaraj është një aktor i përmasave ndërkombëtare që ka realizuar disa role mjaft të rëndë-



sishme. Shqiptari me origjinë nga Kosova është i njohur për rolin e tij në filmin amerikan "Taken", krahas aktorit të shquar Liam Neeson. Një tjetër rol që ka vluosur karrierën e tij është ai në filmin "Harry Potter".



dimisht ngelim me copëza jete. E kemi shumë të vështirë të kemi një jetë në bjeshkët e bukura të Isniqit, ai u lidh shumë edhe me letërsinë dhe më vonë do të zbulonte pasionin për kinematografinë. Vite më vonë ai do të shtonte drejtëndrës për magjinë e tetarit dhe filmit. Fillimisht drejtë Sllovenisë në vitet e luftës dhe më pas në Francë, në vendin ku filloi karrierën e tij dhe ku jeton edhe sot. Arben Bajraktaraj, i cili ka patur fatin të luajë me aktorë dhe regjisorë të rëndësishëm të kinematografisë botërore ishte i ftuar në emisionin "Rudina" në Tv Klan për të folur për rugëtimin e tij. "Nuk e kisha menduar që do të gjenit gjithë këto material, por kjo është në fakt jeta e aktorit, nga një cep në tjetrin dhe nga një jetë në tjetër. Kjo është bukuria e mjeshtrisë tonë, por edhe fatkeqësia jonë, sepse përfun-

seri. Ka qenë një përvojë e jashtëzakonshme. Pas serisë së parë regjisorin më tha se donte të punonte sërish me mua. Aty ishte ajka e aktorëve dhe kam mësuar shumë nga të gjithë", tha Arben Bajraktaraj. Projekti i tij më i fundit që e ka sjellë atë në Shqipëri është edhe filmi "Streha mes reve", film në të cilin ai është protagonist.

AVA MAX:

Shqiptarja Ava Max është këngëtarja e radhës që po merr vëmendjen e botës. Nëse nuk e kemi dëgjuar akoma këngën "Sweet but Psycho", atëherë duhet t'i kushtoni vëmendje, pasi bota është duke e bërë këtë. Kënga është e shkruar dhe këndohet nga artistja Ava Max, emri i vërtetë i të cilit është Amanda Koçi. Amanda është një 24-vjeçare e lindur në Wisconsinin të Shteteve të Bashkuara të Amerikës,



Padyshim që ajo është një nga nënat e reja me sexy që përfliten në mediat rozë. Zaimina Vasjari arrin gjithmonë të tërheqë vëmendjen për shkak të fotove provokuese që ajo hedh në Instagram. Edhe pas lindjes së vajzës së saj Khloe, ajo mbeti po aq provokuese edhe sa më parë duke iu rikthyer formave të saj seksi në një kohë rekord. Së fundmi këngëtarja vjen me një foto mjaft tërheqëse veshur në të kuqe ku bie në pah gjoksi i ekspozuar. 'Santa Zaimina' shkruan këngëtarja.



Zaimina Vasjari poston foto me fustanin seksi, ku i shpërthen gjoksi



Një shqiptar nga Kosova është shpallur "Hero i vitit 2018" në shtetin e Suedisë. Fidan Bejtani u dekorua ditën e djeshme me titullin "Engjëlli Mbrojtës" pasi u shndërrua me të vërtetë në hero duke shpëtuar 20 fëmijë, të cilët ishin pre e një agresioni me thikë të ndërmarrë nga një grua në një park lojërash. Gruaja në fjalë mbante thikën në dorë dhe tentoi të godiste fëmijët teksa po luanin së bashku në një park të Suedisë. Për të shpëtuar fëmijët, shqiptari në momentin e sulmit u përplas fizikisht me gruan agresore, veprim i cili mund t'i kishte kushtuar edhe jetën. Për këtë akt human ka reaguar edhe ish-futbollisti i Kombëtares së Suedisë, Zlatan Ibrahimović, i cili e ka falënderuar kosovarin në emër të të gjithë suedezëve për aktin e lartë human. "Ju jeni një hero i vërtetë. Punë e mirë. Të gjithë janë krenarë për ty. Ajo që bëtë nuk është secili që do të guxonte të bënte. Vazhdo të jesh kështu, vetvetja. Na duhen më shumë si ty. Ju ftoj që të vini dhe të më shikoni një lojë drejtpërdrejt". Sipas mediave lokale, gruaja që sulmoi fëmijët në një park lojërash në Malmö kishte probleme me shëndetin mendor, ndërsa të gjithë kanë ngritur lart veprimin e Fidanit, i cili është shndërruar në një ambasador të shqiptarëve kudo në diasporë.

U shpëtoi jetën 20 fëmijëve nga gruaja me thikë, shpallet "hero" shqiptari në Suedi



nga prindërit emigrantë shqiptarë. Ava ka lansuar këngën debutuese 'My way' në prill të këtij viti, pasi ka nënshkruar me shtëpinë e madhe muzikore, Atlantic Records. Më pas ajo ka sjellë një këngë me reperin shqiptar në Amerikë, Gashin në maj të 2018. Por, hiti më i madh është padyshim 'Sweet but Psycho', kënga e tretë e artistes, me të cilën ka arritur madje të thyejë kufijtë. 'Sweet but Psycho' është ndër këngët më të dëguara në Britani, duke arritur që për dy javë rresht të jetë kënga e dytë më e dëguar e më e shitur, ndërsa pretendon t'ia marrë vendin Ariana Grandes, duke marrë vendin e parë pikërisht për klasifikimet e Krishtlindjeve. Përveç kësaj, po flitet se Ava do të sjellë shumë shpejt një këngë me artisten tjetër shqiptare me famë ndërkombëtare, Rita Orën. MARKO CAKA: Aktori shqiptar, Marko Caka, është

të bërë shumë i njohur kohët e fundit me pjesëmarrjen e tij në shumë filma të njohur hollivudian. Ai ka qenë pjesë e projekteve të mëdha të prodhimit të Hollivudit, duke luajtur pranë yjeve të njohur si: Tom Hanks "Bridge of Spies" (2015), Jim Belushi "Shoë Me a Hero" (2015), Ben Affleck "Batman vs Superman" (2016), Megan Fox "Turtles Teenage Mutant Ninja" (2016). Caka ka marrë pjesë, gjithashtu, dhe tek "Fast and Furious" (2017) duke portretizuar policin operativ gjatë trazirave të burgjeve duke luajtur së bashku me Dwayne Johnson dhe Jason Statham. Së fundmi aktori me origjinë nga Shkodra ka pranuar që do të jetë sërish pjesë e një prodhimi të njohur kinematografik. Në një prononcim për "Telegraf.com", Caka ka treguar se është përzgjedhur të jetë pjesë e kastës së aktorëve të filmit, "Bad boys in life", ku rolin kryesor e ka aktori i njohur Will



Smith. "Ishte ëndërr për mua të luaj pranë Will Smith, të cilit ja kam shprehur në takimin tim të parë dy vjet më parë, dhe që e ka pritur shumë mirë, aq më tepër kur mësoi se jam shqiptar"- ka treguar Marko. Episodi i tretë i këtij filmi ka një pritshmëri të madhe pasi bashkon edhe një herë pas 23 vjetësh dy protagonistet kryesorë Smith dhe Martin Laërence. Sipas "Sony Pictures", në këtë film kanë shprehur dëshirën t'i bashkohen kastit edhe yje të tjerë, por emrat e tyre akoma nuk janë bërë publike nga ana e prodhuesit. Premiera e filmit pritet të shfaqet në ekranet e mëdha të kinemave botërore në fillim të vitit 2020.




BULEVARDI

POLITIK

Na merrni seriozisht!

Kryeministri tregon çfarë i shkruajti një zonjë...

Tëksa dialogonte me studentët e Universitetit Bujqësor të Tiranës, kryeministri përmendi dje edhe postimet e tij të shtuara së fundi në 'Instagram'. "Më shkruante dje një zonjë: 'Ore, ç'a dialogoj kërkon nga ata? Kam dy vite që kërkoj të dialogoj me dy që kam në shtëpi dhe ata nuk përgjigjen. Rrinë tërë ditën në telefon dhe qeshin me vete'. Mua të shkretin më keni bërë instagramist duke dialoguar me shenja aty ku rriin ju",-tha kreu i qeverisë Edi Rama.



Braçe heq kostumin e politikanit dhe na shfaqet si berber

Deputeti socialist, Erion Braçe, përveç politikës që e bën shumë mirë, duket se ka dhe disa pasione tjera të fshehura. Një prej tyre është edhe berberi ose, siç njihet ndryshe në ditët e sotme, si parukieri. Nuk dihet sa mirë di ta bëjë Braçe këtë profesion, por ai ka hequr për pak çaste kostumin e politikanit dhe ka përveshur atë të parukierit. Ka qenë vetë Braçe ai që ka publikuar një foto nga berberhania ku dhe vetë qethet apo modelon mjekrën, por kësaj here na shfaqet jo në rolin e klientit, por atë të berberit. Siç shihet edhe nga foto ai ka veshur përparësen karakteristike të kësaj berberhane, ndërsa është i "armatosur" me gërshërë, krehër, e brisk. Natyrisht që Braçe mund ta ketë pasion këtë punë, por e sigurt është që për tipin "grindavec" që ka vështirë ta bëjë një punë që do talent dhe kreativitet, por mbi të gjitha do durim.

Veliat flet për djalin: la preva kërthizën vetë. I ndërroj pelenat

Kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliat ka treguar shumë detaje nga marrëdhënie e tij me djalin 2 muajsh tashmë, Kajan. I ftuar te e "Diela Shqiptare"

Veliat tregoi se çfarë bën si baba i ri, ndërsa tha se i bën të gjitha, i ndërroj pelenat dhe madje e lan vetë Kajanin. "Kam mësuar ta ndërroj çunin për 30 sekonda. Jam shumë i përfshirë",-tha ai. Veliat rrëfeu se tani nuk ka shumë kohë për të fjetur gjumë pasi Kajani çdo dy orë ose do ndërruar ose do të pijë. "Ose çicin ose çucin", tha Erioni. Por megjithëse lodhet në punë kur vjen në shtëpi gjen kohë të merret edhe me çunin. "I marr erë kur është në gjumë. O shyqyr që erdhe tani, më thotë Ajola, mbaje një çikë ti", tha Veliat, i cili tregoi se ia ka prerë vetë kordonin e kërthizës djalit. "Kam marrë pjesë në operacion dhe më tha doktori se mos të bie të fikët. Unë jam burrë me namuz nuk më bie të fikët. E kalova më shumë sportivitet gjithë lindjen e tij. Unë kërthizën i thashë do ia pres vetë. Jam marrë me gjithë kalamajtë e Tiranës. Ia preva. Një ta fus në lavaman dhe zhllap-zhllap e lava. Unë i laj kakën gjithë Tiranës, se gjithë ujërat e zeza, jo më çunit tim. Shpresoj që do të bëhet djali i mbarë dhe të kontribuojë për shoqërinë tonë",-tregoi Veliat.



Babai i Meghan Markle i shtrin dorën së bijës, apel për ribashkim

Kontakti i fundit mes Thomas Markle dhe Meghan Markle daton në maj në prag të martesës së saj me princin Harry. Pas kësaj ai u përjashtua nga jeta e tij. Tashmë disa muaj më vonë ai i bën thirrje vajzës së tij për t'u bashkuar. I ftuar në "Good Morning Britania" Thomas i bëri thirrje për pajtim me vajzën e tij. "Të dua shumë, ti je vajza ime dhe dua të di se çfarë bën"- tha Thomas. Pa marrë parasysh dallimet tona, ne duhet të jemi në gjendje t'i zgjidhim ato sepse ne jemi pjesë e së njëjtës familje, prandaj, të lutem, kontakto me mua. Shpresoj që kjo gjë të zgjidhet, nuk mund të zgjasë përgjithmonë"- u shpreh ai. Babai i Meghan nuk e shoqëroi në altar vajzën e tij, sepse ai kishte kryer një ndërhyrje në zemër. Meghan dhe babai i saj asnjëherë nuk kanë pasur marrëdhënie të mira. "Nuk kam ndërmend të hesht për gjithë jetën time. Unë e dua shumë vajzën time dhe duhet të di se çfarë bën. Nuk ka rëndësi nëse takohemi ose jo, mjafton ta di që është mirë, më mjafton qoftë edhe një mesazh në telefon"- tha Thomas Markle.

Këshilla

Shumica prej nesh dëshirojmë të kujdesemi mirë për veten tonë dhe ne e dimë se rutinat e mira dhe parandalueset e vetëkujdesit janë mënyra më e mirë për ta bërë këtë. Por mund të jetë, gjithashtu, dërmuese, stresuese, dhe kërkon kohë për të kujtuar të gjitha gjërat që duhet të bëjmë. A keni pirë ujë të mjaftueshëm? A keni marrë një minutë për të medituar? A nuk duhet të ngrihesh dhe të ecësh? Kur hera herën e fundit që keni ngrënë? Apo flini tetë orë? Sa kohë keni qenë ulur në tryezën tuaj? Duke ditur se nuk keni bërë asnjë nga këto veprime të vetëkujdesit, mund të ndiheni jashtëzakonisht të stresuar - pikërisht e kundërta e efektit që vetëkujdesi duhet të ketë. Gjëja e fundit që iu duhet është të stresoheni. Por kur ju keni një orar të zënë, është e vështirë të qëndroni të përgjegjshëm qoftë edhe për veten tuaj, dhe kështu është e lehtë të lini mirëqenien tuaj dhe shëndetin - të rrëshqasë. Dhe kjo është kur problemet shëndetësore - të shkaktuara nga stresi, zakonet e dobëta të të ngrënit, mungesa e stërvitjes ose diçka tjetër - mund të zhvillohen. Për fat të mirë, ka shumë truke për t'iu ndihmuar të kujdeseni për veten. Ata ndihmojnë të largoni stresin duke ju ndihmuar të ndërtoni një rutinë të shëndoshë të vetëkujdesit dhe duke e bërë atë një zakon që është më i lehtë të mbahet. Këtu janë vetëm disa ide dhe aplikacione që mund të ndihmojnë automatikisht që vetëkujdesi të bëhet prioritet - pavarësisht nëse keni dy minuta ose dy orë kohë:

1. Mos bëni asgjë për dy minuta
2. Dëgjoni tinguj të valëve të detit apo pikave të shiut në aplikacione të ndryshme
3. Ngrihuni dhe bëni një shëtitje jashtë.
4. Qëndroni të hidratuar me aplikacione si iDrated, Waterlogged dhe Eight Glasses A Day
5. Harroni të merrni drekë? Temple dhe Time4Lunch mund të ndihmojnë me këtë.
5. Sfidoni veten për të bërë drekën tuaj në mbrëmje.
7. Ndiqni ciklin tuaj të gjumit me vegla të palestës si FitBit ose Jawbone ose aplikacionin për telefon Sleepbot.
8. Provojeni Bedtime Function të iPhone për të dikur kur të zgjoheni dhe kur të shkoni të flini.
9. Programoni disa mo-

ment "mos e shqetësoni" në mënyrë që të mund të përqendroheni te vetja pa shqetësime

10. Shikoni disa foto dhe video të kafshëve të lezetshme
11. Vizitoni një strehimore të kafshëve.
12. Shikoni video mësimore dhe motivuese.

13. Mbani ditar çdo ditë me aplikacione si DayOne
14. Mbani gjurmët e asaj që ju shqetëson me aplikacione si Worry Watch.
15. Vizitoni mjekun tuaj dhe kontrolloni katër numrat tuaj shëndetësor - presionin e gjakut, kolesterolin, sheqerin në gjak

dhe indeksit të masës së trupit (BMI).

16. Lëshoni e mendimet e këqija ose ndërhyrëse me lojëra si Good Blocks.
17. Meditoni për pesë minuta - edhe kjo është e mjaftueshme për të ndihmuar në largimin e stresit
18. Praktikoni joga në

zyre nëse nuk keni kohë të largoheni nga tavolina juaj.

19. Bëni punë vullnetare.
20. Bëni një listë të zakoneve.

Natyrisht, vetë-kujdesi është vetë nga natyra personale - kështu që asnjë gjë nuk do të funksionojë për të gjithë. Gjëja e rëndësishme është të kuptoni se çfarë hapa proaktiv ju doni të bëni për të marrë një trajtim më të mirë për shëndetin dhe mirëqenien tuaj. Dhe, pasi ta keni bërë këtë, lajmi i mirë është se ka shumë aplikacione, faqe interneti dhe truke për të filluar.



Nuk kujtoheni të kujdeseni për veten? 20 këshilla për ta bërë atë rutinë



SOT PERVJETORI

ALI DEMI

Muajt e fundit në jetën e një heroji

Nga Luan Rama

Një nga të parët që do më fliste gjatë për gjendjen e Vlorës në kohën e luftës ishte Rrahman Parllaku, që atëherë njihej me pseudonimin "Hallvaxhiu". Ai ishte me origjinë nga Kukësi, por familja e tij kishte vite që kishte zbritur në Vlorë, ku kishin një dyqan të vogël. Në atë kohë ai ishte një luftëtar i patrembur dhe me një veprimtari të fortë në Njësitin Guerril të Vlorës, të cilin e drejtoje: "Unë u largova nga Vlorë më 11 tetor të vitit 1943, - më tregonte Rrahmani - por unë u ktheva përsëri, për arsye se kur u analizuara gjendja e krijuar në këtë qytet, pas goditjes së rëndë që mori lëvizja jonë nga gjermanët dhe bashkëpunëtorët e tyre, duhej t'i raportonim Komitetit të Partisë së Qarkorit dhe këtë duhej ta bëja unë, sepse unë isha më i informuari për atë që kishte ndodhur. Më kujtohet që më kanë pritur Muzhiku, (Liri Gega) dhe i ngarkuari me detyrën e sekretarit Politik të Qarkut, Ali Demi. Pasi më dëgjua, më pyetën se si duhej të organizohej puna këtej e tutje në qytet. Iu thashë se hë për hë puna duhej drejtuar nga Narta dhe të mbanin lidhje përmes disa shoqëve tona me qytetin. "Muzhiku" shfaqti pakënaqësi për faktin se ishim larguar nga qyteti dhe më urdhëroi që të kthehesha përsëri aty, por Ali Demi nuk ishte dakord me të. Sugjerohi që të dërgohej në qytet një shok më pak i njohur, pasi, sipas tij, mua më njihnin të gjithë, madje dhe femijët dhe isha më i kërkuari nga armiqët. Kjo, sipas Aliut, do të vazhdonte deri sa të njiheshim mirë me situatën. Por Liria nguli këmbë në të sajën..."

Atë natë ranë të flinin në shtëpinë bazë. Pranë tij, Aliu kishte "Hallvaxhiun", atë djalosh trim, shtatlartë, me vetulla të trasha dhe të zeza pis, që komandonte Njësitin Guerril të Vlorës. Aliu ishte i mërzitur. Përse vallë kjo këmbëngulje? Lirinë e njihje mirë, që në bazën e "Shtëpisë 66", në shtëpinë e tij në Tiranë. I dukej një mendim i xhituar, por e kishte kuptuar se nuk ishte të thjeshtë mendimi i saj; urdhri me sa dukej vinte ose nga Enveri, ose nga Dushani. "Aliu ndryshonte nga të tjerët, - kujtonte Rrahman Parllaku. - Ai ishte i thjeshtë dhe njeri që mendonte shumë. Nuk dinte të imponohej dhe të diktonte... kishte një tjetër metodë pune me njerëzit. Me Alium mund të bisedoje lirshëm. Unë jam një nga ata që e kam ndërjet personalisht

Një rrëfim për dajën, siç më kanë folur për të



kujdesin e tij, siç dhe e kam shkruar në librin tim të kujtimeve. Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre!"

Në këto ditë të vështira, Aliu shkonte fshat më fshat dhe fliste me fshatarët, duke u folur për luftën dhe se ora e lirisë po afrohej. Ishte e rëndësishme që partizanët të rinj të mbushnin radhët e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare dhe në veçanti për formimin e Brigadës së V-të Sulmuese. Nga fillimi i shtatorit Aliu, i shoqëruar nga luftëtarë të zonës dhe me automatik në krah, kishte marrë të përpjetën e Malit të Çikës dhe netëve qëndronte në stanet e barinjve. Kishte zbritur në Vuno dhe ishte takuar me komunistët dhe luftëtarët e krahinës. Në atë kohë, "Çeta e Bregut" ishte afruar në Gjorm me urdhër nga Shtabi Qendror që të luftonte kundër fraksionit, edhe pse komandanti i tyre, Neki Imeri, (Vangjo), kunati i Sadik Premtes, nuk donte ta luftonte Sadikun. Pikërisht në këtë kohë kishte ndodhur dhe vrasja e Mynyr Xhindit.

Sapo mori vesh këto, Aliu vendosi që të nesërmen të shkonte në shtëpinë e familjes së tij. Sigurisht

ishte me rrezik, por i armatosur rëndë dhe i shoqëruar nga disa pjesëtarë të Njësitit Guerril për Vlorën, ai u nis. Mynyri i dhimbej. Pasi u siguruan se në shtëpi nuk kishte njeri të dyshimtë, në prag të varrimit, Aliu ia behu në oborr dhe u takua me Arshiun, babain e Mynyrit. E ngushëlloi. Dyshimi për vrasjen e tij e brente gjithnjë. Aty ishte dhe nëna e tij si dhe Baftjari, i vëllai i Mynyrit, të cilin enjihte prej kohësh, njerëz të tjerë dhe një mjek italian, që ata e kishin mbajtur në shtëpi pas kapitullimit të Italisë fashiste. Varrimi u bë i shpejtë dhe Aliu doli para varrit dhe foli. Këtë çast të dhimbshëm, pas kaq e kaq vitesh e tregonte Murati, vëllai tjetër i Mynyrit, i cili nuk u vra në luftë dhe mbeti gjallë nga të tre djemtë e Arshi Halilit.

Murat Xhindi kujtonte se Mynyri kishte katër plumba në trup, një mbropa koke dhe tre në shpinë, të gjithë nga mbropa. Ky fakt bëri të mos kishin asnjë pikë dyshimi se Mynyriin e kishin vrarë. "Në varrim erdhi Ali Demi. Ai mbajti fjalën kryesore dhe vlerësoi lart kontributin e tij të shquar; si një nga figurat e spikatura të luftës

antifashiste të Qarkut..." Këto dyshime nuk ia thanë Aliut ato ditë, pasi ata e kishin të qartë se Aliu pak kohë kishte që kishte ardhur në Vlorë. Për më tepër ishte shok i afërt me Baftjarin. Një ditë më vonë doli trakti i Komitetit Qarkor, për të cilin Aliu kishte dhënë porosi që të shpërndahej menjëherë dhe se çfarë duhej theksuar në atë trakt. Vrasja e Mynyrit ishte një goditje e rëndë. Ky trakt mbante titullin "Fli Tradhëtie". Por për ç'tradhëti bëhej fjalë?... Mënyra si u vra asnjëherë nuk u gjet. Cilët ishin ata që e kishin vrarë dhe kush kishte urdhëruar për këtë?...

Më 21 nëntor, me ndihmën e balistëve, gjermanët bënë reprezalje të shumta në Vlorë duke vrarë e arrestuar shumë njerëz të lëvizjes Nacional-Çlirimtare. Këto reprezalje i tronditën dhe disa nga krerët e Ballit Kombëtar të Vlorës, siç ishte avokati Skënder Muço, i cili pas kësaj ngjarje u shkëput nga Balli, duke denoncuar reprezaljet e bëra në bashkëpunim me gjermanët. Ditët e atij fillim dhjetori të vitit 1943 ishin shumë të ngarkuara. Në malet e Labërisë vepronte tashmë Brigada e V-të dhe gjermanët ishin shqetësuar nga goditjet e vazhdueshme që po merrnin, edhe pse ishin të sigurtë në mbrojtjen e qyteteve dhe të rrugës Greqi-Shqipëri, të cilën e kontrollonin mirë. Një nga ato ditë, një korrier do të shkonte për në Helmës, ku ishte vendosur Komitetit Qendror i Partisë dhe Aliu i dha një letër djaloshit vlonjat për Njazi Demin, shokun e tij më të afërt. I shkruante se "së shpejti edhe ai do të shkonte për një punë në Skrapar dhe me këtë rast donte ta takonte". Edhe pse i angazhuar natë e ditë në luftën çlirimtare, Aliu mendonte gjithnjë dhe për fatin e Çamërisë. Ç'do të bëhej me të pas lufte? Kohët e fundit ishte informuar se që më 2 gusht, ishte krijuar "Çeta Çamëria", e cila vepronte në të dyja anët e kufirit shqiptaro-grek, e prirur nga Taho Sejko dhe Muharrem Demi. Më vonë, në bazën e kësaj çete u krijua dhe batalioni i cili do të çlironte Konispolin, ku krahas Kasëm Demit e Teme Sejkos, luftonin dhe Qamil Buxheli, Selim Islami, Myfit Sejko e shumë të tjerë, të cilët Aliu i njihje.

PRAVERA DY HAPA AFËR

19 dhjetor 1943. "Atë mbrëmje bëmë një mbledhje të rëndësishme në një nga shtëpitë bazë, - më tregoi Dhimitër Mandro një ditë, - ku Aliu foli për situatën e luftës dhe rolin e dëmshëm të ballistëve, të cilët kishin bërë tashmë pakt me gjermanët. Qëndruam deri në mesnatë. Pastaj dolëm të flinin në një nga bazat e tjera. Ramë të flinin. Pa zbardhur



mirë, u dëgjuan trokitje tek dritarja. U zgjuam. Dikush na njoftoi se shtëpia ishte rrethuar nga ballistët, të udhëhequr nga Ismail Golemi. Aliu dhe Pano Dhimgjoka morën automatikët dhe të tre nxituam drejt malit që t'i largoheshim Kaninës. Por pas pak, pas tri katër shtëpish një zë thirrri: Ndal! Dorëzohuni! Jeni të rrethuar!..."

Kanina po zgjohej, por krismat e para e zgjuan gjithë popullin. Pas pak, duke e kuptuar se s'kishin rrugë për të çarë rrethimin, Aliu u tha dy shokëve të tij se ishte më mirë të ktheheshin drejt shtëpisë ku ishin dhe të rezistonin deri sa të vinte mbrëmja dhe pastaj të tentonin të çanin rrethimin. Ishin të vetëm dhe shtigjet e fshatit nuk i njihnin ashtu siç i njihnin fshatarët. Me nxitim u kthyen drejt shtëpisë dhe u thanë njerëzve që banonin në të që të largoheshin që të mos vrateshin nga armiqët. Lufta filloi e ashpër. Pano Dhimgjoka zuri vend tek dera që të mos lejonte njeri të afrohej nga rruga përballë hyrjes së shtëpisë. Aliu ishte në një nga dritaret dhe në tjetrën Dhimitri. Thirrjet nga jashtë për tu dorëzuar vazhdonin. Por si përgjigje kishte vetëm shkrehje armësh. Tashmë drejt Kaninës po afroheshin dhe forca gjermane. Rrethimi ishte i jashtëzakonshëm. Madje gjermanët zunë pozicione dhe në kalanë e Kaninës nga ku mund të vëzhgonin çdo lëvizje. Por rezistenca ishte e fortë.

Nga dreka, pasi e panë se ishte e vështirë që të rrethuarit të dorëzoheshin, ballistët mblodhën popullin në qendër të fshatit dhe i kërcënuan që t'i dorëzojnë të rrethuarit. Por si? Askush nuk pranoi të shkonte drejt tyre. Ndërkohë, nga kodra filloi gjëmi i artilerisë. Aliu e kuptoi se gjyete e para ishin thjesht për t'i impresionuar dhe se gjermanët nuk mund të qëllonin, pasi rrezikonin të qëllonin shtëpi të tjera. Por një orë më vonë, forcat që i rrethonin bënë dhe një përpjekje tjetër për tu afuar. Filloi një shkëmbim i ashpër zjarri. Aliu dhe Dhimitri qëllonin nga dritare të ndryshme për të dhënë përshlyetje se ishin një grup i madh luftëtarësh dhe jo thjesht tre persona. Në një moment qetësie, Aliu i tha Dhimitrit t'i thoshte Panos të bëhej gati që të çanin rrethimin. Nuk kishte asnjë rrugëdal-

Dje / në "Deutsche Welle"

Paris, Budapest, Tiranë: Po proteston gjysma e Europës?

Nga David Ehl

(vijon nga faqja 1)

... mbrëmje u mblodhën në kryeqytetin hungarez nuk mbajnë qirinj, por telefona në duart e tyre - dhe mesazhi i tyre nuk është fetar, por politik. Ata kërkojnë që Kryeministri Viktor Orban të tërheqë ligjin, sipas të cilit kërkohej që punëdhënësit të mund të kërkojnë deri në 400 orë pune shtesë jashtë orari nga punëtorët e tyre.

Që nga votimi parlamentar të mërkurën e kaluar, gjithnjë e më shumë njerëz po mobilizohen kundër këtij "ligji të skllervëve", siç u quajt ai, madje ka pasur trazira të dhunshme. Të dielën, protestat ishin të qeta në fillim, më vonë policia përdori përsëri gaz lotsjellës. Me 10,000, ndoshta 15,000 pjesëmarrës, ky ishte kulmi i një valë proteste që nuk ka ndodhur në Hungari gjatë mandatit tetëvjeçar të Orbanit. Edhe në Francë protesta e sapo e "jelekëve të verdhë" erdhi pas një shpalljes së një ligji. A po ndodh tani në rrugët evropiane "ngrohja globale" e klimës politike?

Hungaria: "Largohu Orban"

Shumë demonstrues shprehën nëpërmjet thirrjeve të tyre se ata janë nuk e mbështesin jo vetëm ligjin e orareve shtesë së punës, por as politikën sociale të kryeministrit të tyre. Nën udhëheqjen e Viktor Orban, punëtorët humbën gjithnjë e më shumë të drejta, ndërkohë që pozicioni i sipërmarrësve u forcua edhe më tej. Gjithashtu, ka pakënaqësi me veprimet e Orban kundër të pastrehëve dhe emigrantëve dhe operacionin e tij të shpëtitimit për ish-kryeministrin



maqedonas Nikola Gruevski, i cili është dënuar me burg në vendin e tij.

Serbia: Kundër pushtetit shtetëror

Në Beograd në kryeqytetin e Serbisë, në këtë fundjavë mijëra vetë dolën sërish në rrugë. Shumë prej tyre e shprehën zemërimin ndaj qeverisë me bilbila si në protestat masive kundër regjimit të Millosheviçit në vitet 1990. Shkak-

tari për protestat aktuale ishte një sulm brutal ndaj një lideri të së majtës serbe, Borko Stefanoviç. Njerëzit me këmisha të zeza e kishin rrahur politikanin në fund të nëntorit në qytetin jugor të Kruševcit me një shufër metalike të hekurit dhe e kishin plagosur rëndë. Presidenti Vuçiç e dënoi sulmin dhe autorët e krimit u kapën. Por opozita vazhdon të fajësojë retorikën e mprehtë të

Vuçiçit për një klimë dhune në vend.

Shqipëri: Më shumë se sa taksat e larta të shkollimit

Në Shqipëri, që nga fillimi i muajit studentët po protestojnë për uljen e tarifave të shkollimit. Në universitetet shtetërore, tarifat variojnë nga 160 dhe 2560 euro, të ardhurat mesatare në vendin e varfër ballkanik janë vetëm 350 euro. Megjithatë, demonstruesit

në kryeqytetin e Tiranës dhe në disa qytete të tjera të vendit gjithnjë e më shumë po shtojnë kritikën edhe ndaj qeverisë së kryeministrit Edi Rama. Ndër të tjera, me bllokimin e rrugëve ata tërhoqën vëmendjen për varfërinë e përhapur në vend dhe çmimet e larta të benzinës.

Francë: Si do të vazhdojnë më tej "jelekët e verdhë"?

Bllokimi i rrugëve për shkak të çmimeve të larta të benzinës kishin filluar disa javë më parë në Francë, protesta e "Gilets Jaunes". Protesta gjithnjë e më masive, mbarëkombëtare, pas koncesioneve të presidentit Emmanuel Macron dhe sulmit në Strasburg e ka humbur pak vullmin. Nivelet e protestave në Paris fundjavën e kaluar ishin shumë prapa atyre të javëve të mëparshme. Dimensionet e protestave në Paris javën e kaluar ishin larg atyre të javëve të mëparshme.

Programi emergjent prej miliardë dollarësh, i cili ndër të tjera, parashikon një rritje të pagës minimale me 100 euro, në vitin 2019 e vë Francën në vështirësi buxhetore. Parisi ka gjasa të bëjë më shumë borxhe sesa e parashikon Pakti i Stabilitetit të Euros. Objektiv i tyre origjinal heqja dorë nga rritja e eko-taksave në lëndët djegëse fosile, është arritur nga "jelekët e verdhë". Sidoqoftë, lëvizja në pak javët e ekzistencës së saj, ka dhënë një dinamizëm të jashtëzakonshëm dhe në një farë mënyre është rritur fuqishëm në drejtime të ndryshme politike. Por kjo rritje e shpejtë mund ta dëmtojë lëvizjen, nëse qëllimet e palëve ndryshojnë aq shumë sa që nuk mund të bien dakord për një agjendë të përbashkët.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



Opinioni *i* Ditës

Më mirë 100 studentë në shesh, se 10000 militantë!

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

... rikujton se drejtohej kundër njerëzve që kishin mundur fashizmin dhe themeluar Bashkimin Evropian, ngjan si shumë apokrifë.

Ngjan se më shumë sesa thelb, protestuesit kërkonin një imazh të ri. Çka do të sillte atë që po vuajnë sot: udhëheqës që më shumë rëndësi i kushtojnë imazhit të qeverisjes, sesa thelbit të saj; më shumë kujdes për humorin e turmave, sesa politika afatgjata.

Por, ajo lëvizje sollti edhe një troshitje të establishmenteve të fosilizuara, hyrjen e të rinjve në politikë dhe bërjen e politikës më njerëzore.

Dhe qeverisja "Rama" është shembull përfaqësues i imazhit, si gjithçka dhe brendisë si asgjë.

Por, diferenca mes '68-ës dhe 2018-ës shqiptare është se ata që presin të përfitojnë nga kjo lëvizje janë të njëjtët që kanë qeverisur 28 vite.

Dhe përballë tyre, Rama ngjante një hap para, ndërsa opozita shqiptare duket demode ose jashtë kohe.

Përfaqësues të saj të veshur me golf, apo fustane firmato nuk e fshehin dot vjetërsinë e saj, apo snobizmin provincial. Ashtu sikurse e njëjta gjë është tek pozita, ku koketat e saj me flokë të hekurosura apo ndryshimin nga lekat e para pese vjetëve në firmat që nuk ju rrinë rehat në trup, të bëjnë të qeshësh e qash.

Por këtë e mbulon Rama si "One Man Show".

Gjithë këtë snobizëm dhe cektësi të kësaj klase politike e zhveshi protesta e studentëve. Protesta e fundit e studentëve shqiptarë ishte një shembull sesa shumë përpara ka ecur brezi i 120-vjeçarëve të sotëm. Me sloganet, memet, parullat e tyre na bënë të kuptonim se mes një Shqipërie ku ekranet dhe jetën publike e kanë zënë dinosaurët e politikës, aty në hije është rritur një brez evropianësh të rinj.

Ky brez tregoi sesa e vjetër është klasa politike shqiptare, se edhe pse disa prej deputetëve janë të rinj në moshë, ata janë lindur po aq pleq sa mentorët e tyre; sesa hajdutë demode janë shumë prej tyre dhe sesi asnjë figurë e rresh-



tit të parë të politikës shqiptare nuk duhet më të përfaqësojë shoqërinë shqiptare.

Që në fillimet e saj, kësaj proteste iu bashkëngjiten partitë politike.

Për fat, në ditët e para, nuk ia dolën t'i japin tonin dhe ngjyrën.

Me kalimin e ditëve, ndërhyrja e partive të opozitës u bë edhe më agresive.

Ishte një përpjekje e tyre për të vjedhur lëngun dhe fantazinë rinore të protestës që entuziazmoi shqiptarët.

Dhe militantë 70-vjeçarë dialektorë, apo koktope mitingjesh po shfaqen gjithmonë e më tepër. Gjithmonë e më tepër mbizotërojnë militantët që u zbythën para 5 vjetëve nga shqiptarët pikërisht për arrogancën, tahmaqarllëkun

dhe makutërinë e tyre, të cilët presin të rihyjnë në zyrat në të cilat i kanë zëvendësuar një tufë inkompetentësh të rilindjes.

Në fakt janë ndihma më e madhe për Ramën.

Kështu po u zverdhin shqiptarëve këtë protestë të fëmijëve të tyre.

Të dëshpëruar për mbijetesën e tyre, partitë e opozitës po ndihmojnë në fakt Ramën, i cili edhe pse në shterim të fantazisë së tij, gjithsesi ngjan më ndjellës në sytë e publikut.

Këtë të hënë, protesta më shumë se e studentëve, duket se do jetë e partive politike.

Do të preferoja më shumë 100 studentë në shesh, sesa 10 mijë militantë.

Rama ka frikë studentët. Mili-

tantëve ua ka marrë dorën. Por mesa duket, edhe pse armiq në dukje, Rama dhe opozita po ia dalin të shuajnë lëvizjen e studentëve.

Rama duke i lodhur me tezën sterile që t'i çojnë përfaqësinë, ndërsa opozita me gërryerjen nga brenda për t'i marrë lëvizjes limfën dhe imazhin.

Por nëse kjo lëvizje do të shtohet si opozitare, por shuhet si studentore, dhe do dështojë, ata që do humbasin do të jenë studentët.

Shpresoj që kjo të mos ndodhë dhe të shohim prapë sloganet dhe meme, që aq shumë na pëlqyen në këto ditë dimri, sesa sloganet boshe të një opozite që po pret të hyjë prapë në zyrë dhe zhatë çfarë kanë mbetur nga koncesionet 10-vjeçare të Ramës./dritare.net

HOROSKOPI

DASHI

Do të mendoni seriozisht sesi do të organizoheni për festat e fundvitit. Do të mendoni edhe për dhuratat që mund t'i bëni familjarëve. Sa i përket marrëdhënies me partnerin/partneren tuaj, do të përballeni me disa momente të vështira, por kjo do të jetë e përkohshme dhe shumë shpejt do t'i ktheheni normalitetit.

DEMI

Kjo ditë do të jetë plot incidente dhe rastësi. Mbani veten nën kontroll dhe mos u përpigni t'u jepni përgjigje menjëherë të gjitha pyetjeve. Lërin gjërat të ecin vetë dhe së shpejti do të kuptoni që po ndodhin ndryshime pozitive.

BINJAKET

Disa çështje mund të dalin jashtë kontrollit sot. Nuk do ta gjeni dot fajtorin për këtë, ndaj mos u zemëroni me personat rreth jush. Mësoni të përballeni me të vërtetën dhe ka gjasa që të jeni ju fajtor për vështirësitë me të cilat jeni përballur sot.

GAFORJA

Mund të kryeni disa detyra aspak të këndshme sot. Megjithatë, kjo do t'ju japë mundësinë të tregoni profesionalizmin tuaj. Gjithashtu, një miku juaj i ngushtë do të ketë nevojë për ndihmën tuaj, për të cilin do të tregoni shumë i gatshëm.

LUANI

Shumë Luanë do ta kalojnë pjesën më të madhe të ditë duke menduar për organizimin e festave të fundvitit dhe veshjet që do t'iu duhen. Jepini prioritet komfortit dhe besimit. Duhet të gjeni kohë për t'u relaksuar, por do të ishte mirë të mos e tregonit.

VIRGJERESHA

Ka gjasa që mund të ftohemi, ndaj kujdesuni për veten dhe veshjen e duhur. Megjithatë, për disa persona të tjerë të kësaj shenje gjërat mund të ecin ashtu siç do të dëshironit, përfshi këtu edhe disa të vështirësi lidhur me karrierën tuaj.

PESHORJA

Disa persona të kësaj shenje do të kenë një sjellje misterioze. Ndoshta mund të keni dëshirë për të diskutuar rreth çështjeve të ndryshme. Përgjigjuni me takt kërkesave për ndihmë ndaj të tjerëve.

AKREPI

Kushtojni më shumë kohë familjarëve dhe mos e tregoni me argëtim. Ka gjasa të surprizoheni nga diçka që mund t'ju ndryshojë rrethën e ditës. Ka mundësi ish-partneri juaj të rikthehet sërisht, duke i vënë në duarime rreth vendimit tuaj.

SHIGJETARI

Do të ndiheni shumë e lodhur për shkak të punës sot. Në mbrëmje do të shijoni qetësinë dhe do të keni dëshirë vetëm për t'u relaksuar. Do të zhvillonit disa biseda të ngrohta me familjarët tuaj që do t'ju bëjnë të ndiheni shumë optimistë.

BRICJAPI

Disa Bricjapë do ta kalojnë kohën duke zgjidhur disa çështje organizative. Mund të bëheni pjesë e një projekti të ri së bashku me partnerin/partneren tuaj. Do të shqetësoheni nga sjellja e dikujt përreth jush.

UJORI

Ujorët mund të frymëzohen sot nga një ide e re. Ka mundësi që pak më vonë kjo ide t'ju krijojë mundësi për të ardhura të tjera, ose të arrini një pozicion më të lartë në punë. Megjithatë, ka gjasa që të keni përplasje me një kolegun tuaj.

PESHQIT

Mund të ndiheni të zhgënjyer nga rezultatet e një dite më parë. Megjithatë, mendoni për aspektet pozitive të jetës dhe harroni detyrat e papërfunduara për momentin. Përpigni ta gëzoni veten, duke u përfshirë në një aktivitet argë-

BLUE TOOTH
THASHETHEME MADE IN ALBANIA

te rejat nga jeta ipave

069 111 111

Një lajm i bujshëm vjen nga Anglia, pasi klubi i Manchester Junajtid ka vendosur të shkarkojë nga detyra Zhoze Murinjon. Edhe pse tekniku portugez mendohej se do të çonte deri në fund aventurën e tij në këtë sezon me "djaljtë e kuq", klubi ka marrë vendimin për ta larguar dhe e ka bërë gjithçka zyrtare me një komunikatë të publikuar dje. "Manchester Junajtid bën

të ditur se trajneri Zhoze Murinjo është larguar nga klubi me efekt të menjëhershëm. Klubi dëshiron të falënderojë Zhoze për punën e tij gjatë periudhës të Manchester Junajtid dhe t'i urojë suksese në të ardhmen. Një trajner i përkohshëm do të emërohet deri në fund të sezonit aktual, ndërsa klubi do të nisë procesin e kujdesshëm të emërimit të një trajneri me kohë të plotë", shkruhej në njoftimin e klubit, që bënte zyrtar shkarkimin e Murin-

Portugezi përfiton 22 milionë paund nga prishja e njëanshme e kontratës

E bujshme, Junajtid shkarkon Zhoze Murinjon

jos. Ky ishte sezoni i tretë i tij me "djaljtë e kuq" dhe në eksperiencat e mëparshme në klubet që ka drejtuar, Murinjo nuk ka zgjatur asnjëherë më shumë se tri edicione. Edhe eksperiencia e tij e mëparshme, ajo të Çelsi, mbaroi

në edicionin e tretë, pikërisht në dhjetor, pasi u shkarkua nga klubi. Por si atëherë, edhe në shkarkimin aktual, Murinjo largohet me një valixhe me para dhe sigurisht, jo i pakënaqur. Sipas marrëveshjes aktuale, ai do të përfitojë 22,5

milionë paund për prishjen e njëanshme të kontratës nga klubi, ndërsa nga Çelsi kish-te përfituar rreth 15 milionë paund nga shkarkimi i tij. Sidoqoftë, dështimi të Junajtid nuk e bën atë një trajner të padëshiruar. Ka ende klube

në Europë, të cilat janë të gatshme të bëjnë çmenduri për të. I pari është PSG, i cili e ka ndjekur për shumë vite me radhë dhe mund t'i ofrojë mundësinë të punojë me francezët nëse dështon projekti me Tuhel. I dyti është Inter, i cili kërkon një trajner për të zëvendësuar Spaletin, i cili nuk ka bindur as drejtuesit dhe as tifozët. Megjithatë, portugezi parashikohet të qëndrojë pushim deri në fund të sezonit, për të marrë drejtimin e një skuadre të re vetëm në verë.



Jeton Selimi

Presidenti i federatës së futbollit prek disa nga temat më të nxehta në një intervistë

Duka: Skënderbeu s'po cedon, unë në UEFA, ngjitet edhe Shqipëria

Vlerëson trajnerët shqiptarë: Gati për Kombëtaren!

Presidenti i FSHF-së, Armand Duka, në një intervistë për "Top Channel" bën bilancet e vitit 2018 për Superiore, Kombëtaren, apo edhe në lidhje me problemet financiare të klubeve dhe kandidimit të tij për një vend në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s.

SUPERIORJA

"Është një garë edhe më e fortë se ajo e edicionit të kaluar dhe e organizuar edhe më mirë. Në të gjitha këndvështrimet është një kampionat më i mirë sesa i mëparshmi".

Stadiumet

Kushtet e stadiumeve. Ndoshta është edhe transmetimi i drejtpërdrejtë i të gjitha kampionateve të tjera, qartazi më të fortë sesa i yni. Kështu, nëse do të luhet një ndeshje Real-Barcelona, njerëzit preferojnë të rrinë në shtëpi e t'i shohin të dyja, pasi edhe Superiorja transmetohet drejtpërdrejt. Menaxhimi dhe promovimi nga vetë klubet dhe mënyra sesi duhet t'i afrojnë ata, të gjitha këto nuk janë bërë mirë".

SKËNDERBEU

"Nuk shoh asnjë cedim në kampionat nga Skënderbeu. Ka pasur angazhim maksimal dhe është shumë i interesuar për të pasur një klasifikim sa më të mirë. Nëse do të lejohet të marrë pjesë në sezonin e ardhshëm në kupat



e Europës, apo jo, këtë do ta vendosë CAS-i".

KASTRIOTI

"Nuk është asnjëherë një gjë e mirë kur krijohen shkëputje nga fillimi apo nga fundi, duke e bërë më pak të interesuar garën. Ekipet duhet ta vlerësojnë maksimal-

isht ndeshjen, në fund të fundit kjo është një lojë për të cilën kanë bërë maksimumin për t'u ngjitur në Superiore".

TIRANA

"Më vjen keq për pozitën ku është Tirana, pasi ka mundësi më shumë sesa të tjerët. E përsëris që më vjen

keq, por kjo nuk mund të përmirësohet me urim e nuk mund të përmirësohet me dëshirë, nëse nuk do të ketë një menaxhim më të mirë, gjë që i mungon Tiranës. Nëse nuk do të ketë një menaxhim më të mirë, Tirana do të vazhdojë të vuajë".

FINANCAT

"Klubet nuk do të tentojnë të paguajnë më tepër sesa i kanë kapitalet e tyre. Ky është një gabim i madh. Çdo klub duhet të ketë një buxhet të parashikuar dhe të mbulojnë shpenzimet e tyre me të ardhurat që vijnë nga vet klubi, nga vetë futblli, nga të ardhurat e së drejtës televizive, nga të ardhurat e biletave e sponsorëve e të tjerë. Ka qenë një lloj periudhe tranzicioni, e cila forcohet vit pas viti për të ardhur në idealen, që ne nuk do të lejojmë me klube me bilance negative".

KOMBËTARJA

"Për ambientimin e stafit teknik, pas një stafi të suksesshëm që arriti me Shqipërinë të na çonin në 'Euro 2016'. Për evidentimin e disa futbollistëve të rinj, që do t'i kemi edhe për kualifikueset e ardhshme të Europianit".

TRAJNERËT

"Shkolla shqiptare e tra-

jnerëve ka filluar rreth vitit 2004, e njohur ndërkombëtarisht, e njohur nga UEFA dhe me licencë që mund të punosh në çdo vend të Europës. Por, mund të konsiderohet një shkollë e re, nga 2004 në 2018 janë pak vite. Gjithsesi, produktet e kësaj shkolle janë trajnerët e rinj që ju sot shihni në pankina, e që jam i bindur që janë të gatshëm që, sa më shumë eksperiencë të marrin, të drejtojnë edhe ekipin Kombëtar A".

GARA NË UEFA

"Ka qenë i njëjti qëllim edhe tani, si dy vite më parë, të shoh Shqipërinë në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s. Singërisht nuk e kam menduar ndonjëherë të shoh Armand Dukën si anëtar të Komitetit, por në qdo lloj vendi të shoh Shqipërinë një pozicion më lart. Ky ka qenë qëllimi, qoftë herën e parë, qoftë edhe tani. Gjithsesi, edhe këtë e shoh si sport!".

FANTAZISTI LË LUFTËTARIN

Zyrtare, Rroca firmos për Kukësin

Nuk ka më dilema, Eduard Rroca nga muaji janar do të jetë lojtar i Kukësit. Dje në Tiranë, fantazisti që luan prej katër sezonesh me Luftëtarin, i shoqëruar nga presidenti Grigor Tavo, zv.presidenti Harrallamb Tavo, kanë zhvilluar takime intensive me kreun e klubit të Kukësit, Safet Gjici, si dhe drejtorin sportiv, Nderim Nexhipi. Fillimisht Tavo ra dakord me

Gjicin për shumën e blerjes së Rrocës, ndërsa më pas presidenti i Kukësit bindi lojtarin për pagën që do të ketë dhe marrëveshjen e re, duke filluar nga janar. Për "Panorama Sport", klubi i Luftëtarit zyrtarisht konfirmoi: "Po, kemi mbyllur marrëveshjen me Kukësin për shitjen e Rrocës. Lojtari do të luajë ndeshjen e fundit me Luftëtarin të dielën dhe më pas do të jetë në dis-

pozicion të Kukësit". Gazeta mëson se përveç 50 mijë eurove që do të kalojnë në logarit të Luftëtarit, klubi gjirokastërit ka ruajtur 15% të kartonit në rast rishitje të fantazistit nga Kukësi drejt një ekipi tjetër. Në lojë për Rrocën ishte edhe Partizani e Skënderbeu, por Kukësi mesa duket fitoi duelin e parë të madh në merkaton e janarit.

Por, Kukësi është gati të përfitojë


Partizani, për fitoren dhe Shkurtajn në Gjirokastrë

Partizani është shpallur kampion dimri, por titulli simbolik nuk e ka vendosur në gjumë ekipin e Skënder Gegës, që po përgatit ndeshjen e fundit të këtij viti kalendarik në Gjirokastrë. Një vit më parë të kuqtë pësuan humbjen më shokuese në histori, teksa u mposhtën me pesë gola diferencë nga Luftëtari i Abazajt dhe Bregut. Kësaj radhe Partizani kërkon të shmangë befasi të pakëndshme, ndërsa do të ishte një fitore për të konsoliduar vendin e parë në renditje. Por, në Gjirokastrë drejtuesit e kuq nuk po ikin vetëm për 90 minutat e ndeshjes. Par-

tizani është vënë në gjurmët e Vasil Shkurtajt dhe brazilianit Xhekson. Sulmuesi, ish-lojtar i përfaqësueses U21, është një njoheje e vjetër e Gegës, me këtë të fundit që i ka hapur dyert në Kombëtare lojtarit shtatlartë, ndërsa Xhekson do të ishte një alternativë shumë e rëndësishme në krahuin e majtë të mbrojtjes, çka do ta lejonte Trashin të zhvendosej në pozicionin e tij natyral. Gjith-

sesi, të kuqtë janë duke parë me vëmendje dhe për një mbrojtës të djathtë, pasi për momentin në atë rol është vetëm Labint Ibrahim, ndaj ai pozicion duhet dubluar patjetër. Një nga mangësitë e këtij Partizani kanë qenë alternativat e pakta në stol, problem që është prekur në jo pak raste nga trajneri Gega, i cili gjithsesi grupit aktual ka arritur t'i marrë maksimumin deri më tani.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. I famshëm ai i Delfit.
8. Ai elektoral që duhet kapërcyer.
13. Një raketë... atdhetare.
14. Val aktor.
15. Kazan regjisor.
16. Pak formalitet.
17. Eshhtëa Au në tabelë.
18. Të fundit në surf.
19. I mbjell... katastrofa.
24. Fillojnë masat.
25. I bëjnë të luajturit.
26. Mbyllin një krah.
27. Janë trupa qiellore.
28. Preferojnë zjeh të hënën.
29. Vanessa violiniste.
31. Beton pa kufij.
32. Ente Operative Tiranë.
33. Winslet aktore.

34. Një stacion... anijesh.
36. Atëherë kur dalin zjeh.
39. Një djalë vajze.
40. Këndohet në opera.
41. Pak elementare.
42. Një pjesë e origjinës.
44. Eshhtë bota jashtë ëndrrës.
46. Eshhtë shuma e përgjithshme.
48. Totale pa zë.
49. Merret me të bukurën.

VERTIKAL

1. Eshhtë melodramë.
2. Një Schumacher... jo kampion.
3. Ai i shenjtë është Papa.
4. Lidhet në... fyt.
5. Arturo i Brecht.
6. Fillojnë lojën.
7. Luhet në ekstreme.
8. Kishin flamurtë z.
9. Role pa zë.
10. Pak amatoriale.
11. Eshhtë shkronjë.
12. Personazh i Dickens.
14. Ishin bashkitë dikur.
16. Eshhtë edukimi në palestër.
20. Papis aktore.
21. Qytet italian.
22. Një pëlhurë sintetikë.
23. I bëjnë testet me një set.
25. Një monument... për kujtim.
27. Mund të jenë me katër kohë.
28. Një ushtarak me... numër.
29. Kryeqyteti i Filipineve.
30. Ai i shenjtë është papa.
35. Një pjesë e talenteve.
37. Numri i oktetit.
38. Eshhtë sport me stil të lirë.
43. Gjysmë raketë.
45. Ekstreme në ekstreme.
47. Fundi i turandot


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Eshhtë baba.
5. Të fundit në studim.
7. Gustave, piktori që ilustroi Komedinë Hyjnore.
11. Lidhin brigje.
12. Mban në kokë një tiarë.
14. Janë poezi.
16. Qetësonite detin.
17. Koloneli i shkurtër.
18. Inicialet e Mallé regjisor.
19. Mbeten në fund.
20. Qethi Sansonin.
22. Sateliti i Jupiterit.
23. Në mes të Tommy dhe Jones aktor.
25. Thirrej El Pibe de oro.
29. Eshhtë shkaktori i sherrit.
29. Një vegël edhe Stradivari.
30. Fillojnë një penudhë.
31. Bukuroshja e Euroes.
32. Kështu thirrej Felix Tournachon.
35. Del Piero për tifozët.
36. Fundi i një samurai.
37. Vjen vonë pas të vjelave.

VERTIKAL


38. Fillojnë tatëpjetën.
40. Eshhtë gjak i mbretit.
42. Pak diktaturë.
43. Janë rivalet në dashuri.
47. Janë filmat me drita të kuqe.
50. Thuret me makinacione.
51. Një Baba përrallor.
1. Eshhtë galeri në hekurudhë.
2. Një mund të jetë cirku.
3. Pishtarë pa pishë.
4. Matet pa kufij.
5. Mbyllin një princip.
6. Mund të jenë spaghetti të tilla.
7. Këndonite Ciao amore ciao.
8. Prodi që u pasua nga Berlusconi.
9. McBain shkrimtar.
10. Eshhtë shtypja në barometër.
13. Ishte Kombësia e Chopin.
15. Fara këngëtare.
20. Vrau Goliatin.
21. Një i mbijetuar nga Sodoma.
24. Janë nofka.
25. Eshhtë frut i sherit.
26. Në krye të arnatës.
28. Teket e një rrote.
29. Kilmer aktor.
30. Përhapet me frikë.
31. Parashitesë zmadhuese.
32. Në krye të komandës.
33. Afrohen nga kreu.
34. Ishte futbollisti i famshëm për një gjethë të thatë.
37. Ndiqet me ilaçe.
39. Agjenci Martesore Rumune.
41. Kastile janë në fund.
44. Hapen në kufij.
45. Fund janari.
46. Inicialet e Gide.
48. Të parat në olimpiadë.
49. Në krye të titullarëve.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

2		1	6					9
							8	
6	4		9	3				2
		3		1	7			5
	1	4						6
3	9	5	7		1			
		5		2	9	4		
8			5		3			
	6	8	3	4				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	2	9	5	8	7	3	4	6
5	3	6	2	4	9	7	8	1
4	7	8	6	3	1	9	5	2
7	4	2	8	9	6	1	3	5
9	5	3	1	7	4	6	2	8
8	6	1	3	5	2	4	7	9
2	9	4	7	6	8	5	1	3
3	1	7	9	2	5	8	6	4
6	8	5	4	1	3	2	9	7

Argëtim filozofik

- Eshhtë gabim të lejosh që dita të gjykohej në mbrëmje, sepse atëherë, tepër shpesh lodhja bëhet gjykatëse e forcës, e suksesit dhe e vullnetit të mirë.

- Mjeshtërinë e ke arritur atëherë kur as nuk gabon dhe as nuk nguron në të ushtruarin e diçkaje.

- Disa bëhen me turp kundrejt lavdërimeve të mëdha, të tjerët bëhen të paturp.

- Kur doni të veproni, duhet të mbyllni portat e dyshimit.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

1	H	6	A	R	11	K	16	3	8	9	11	S	U	L	M	S	M	M	A	S	A	T	
6	3	9			5	9	8	2	4	7	6	A	R	B	E	E	M	L	I	M	A		
4	2	5	5		13	6	4		4	2	8	K	D	E	L	E	G	A	T	E	T	L	
6	12		6	16	7	4	9	8	9	6	6	M	I	T	O	M	A	N	E	T	D	E	
3	7		1	7	8	6	10	2	8	6	10	K	O	M	U	N	I	T	E	T	E	T	N
7		1	6	3	6	12	7	4	6	6	6	O	P	E	R	A	T	O	R	E	T	F	T
13		7	4	6	6	6	6	6	12	7	10	P	N	I	E	N	O	G	A				
6	4	3	9	10	7	4		13	14			P	S	N	N	I	M	A	L	L	I		
10	6	4	6		12	5		6	4	10		A	M	I	A	N	T	K	O	S	E		
	11	6	12	10	6	10	6		10	4	6	N	O	T	E	K	I	P	O	R	E		
6		9	6	14		6	3	6			4	I	T	N	E	T	I	L	E	N	I	E	
3	9	11			3	4	6	16		3	7	K	R	I	M	I	S	I	R	T	A	K	I

Thënie të mençura

- Duhet patur frikë nga ai që urren vetveten, sepse ti mund të jesh viktimë e zemërimit dhe e hakmarrjes së tij.
-
-
- Sa më shumë që ngrihem, aq më shumë të vegjël dukemi në vështrimet e atyre që nuk dinë të fluturojnë.

- Nëse në nuk e trajtojmë me respekt nderin e njërvetë të tjerë, po aq në monologjet tanë sa dhe në publik, atëherë jemi njerëz të pandershëm.
- Mënyra për të jetuar më mire dhe më i patrazuar është ajo e mendimitarit, sepse, që ta themi pa e zgjatur atë që ka rëndësi, ai ka më shumë nevojë për gjërat që të tjerët i përcmojnë dhe i braktisin.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIË TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

K U R S I M I P T N D
 A N K A D I V A N A
 L O T E P T R E N A T
 I H I P O K R A T I M
 A E R O S T A T I I D E
 D I K A S T E R E T N O R
 E D U I A E R E N E I A
 T A R E R R T D E T
 A N A E U T A N A S I A
 E T I R O M O N I S J A
 E T S P A A K L A E R T I
 M I S S U U A B D E R A
 I L K F R O B E R T O
 T P E R R A L L A N D I
 K A N E L L E T A T R
 R E P A R T E N S A O
 T A R E S I P N
 H E R E T T R U K E T I
 O R E T R E A L K U P A
 R E T I T M E T T O
 R E N D O M N E T T E R
 A H O T E L E T T R I O
 T I K A T E R

FJALËKRYQI (2)

